REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

KËSHILLI I BASHKISË

Datë 01.08.2025 Prot.41 (dyzetëenjë)

Protokoll nr. 41

I mbajtur sot më datë 01.08.2025, në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak Maliq, në sallën e mbledhjeve të këshillit të bashkisë, ora 10:00.

Rend Dite:

1.Hapja e mbledhjes (korumi, miratimi i rendit të ditës, vendimet e mbledhjes së kaluar);
2.Deklarimi i konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimmarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 30.06.2025.
4. P-V "Për miratimin e përfituesve nga programi subvencioni i intresave të kredisë për strehim";
5. P-V"Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB-në nr.129, datë 26.12.2024, "*Për miratimin e numurit të punonjësve, nivelin e pagave të administratës së bashkisë Maliq dhe strukturave të tjera, për vitin 2025";*
6.P-V "Për miratimin e përditësimit të pjesshëm të listës së inventarit të pronave, të transferuara me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.524, datë 30.06.2010 "*Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Gorë, të Qarkut të Korçës*";
7.P-V Për miratimin e transferimit në pronësi të Bashkisë Maliq, të pasurive me numër 334 dhe 336, Zona Kadastrale 2965, fshati Pirg dhe përditësimin e pjesshëm të disa pronave, në listën e inventarit të pronave, të transferuara me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 826, datë 21.11.2012 "*Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Pirg, të Qarkut të Korçës*";
8. P-V "Për miratimin e planit lokal të manaxhimit të integruar të mbetjeve të ngurta urbane të Bashkisë Maliq 2025-2035";
9.P-V "Për dhënie Tituj Nderi";
10.Shqyrtimi i kërkesave drejtuar Këshillit Bashkiak Maliq.
11.Diskutime të tjera.

Këshilltarë të pranishëm në sallë:

Ornildi Demollari; Ronaldo Skënderi; Pranvera Begolli; Dritan Çami; Petrit Kupe; Idlir Limllari; Gentiana Drabo; Rovena Terolli; Fevri Sherifi; Floreta Zaçe; Kristina Malelli; Aramando Daullari; Ilia Xhuti; Almir Elezi; Andonaq Risto; Dalina Krekas; Yllson Ibrahimllari; Faslli Zholi; Eglantina Balli;19 (nëntëmbëdhjetë) këshilltarë

Mungesa: Eriseld Jonusllari;Danjela Ibrahim; Marinathi Avrami; Xhuana Hoxhallari; Enida Avdolli; Klea Baçi; Marjeta Xhelollari; Server Xhuti; Lulëzim Hoxhaj; Albina Xhejo; Neresida Shindo; 12 (dymbëdhgjetë) këshilltarë.

Të pranishëm nga Administrata: Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu; Drejtori i Pronave Publike dhe Aseteve:z.Johand Sula; Përgjegjësi Sektorit të Bujëqsisë: z.Arben Dullillari; Përgjegjës i Zyrës të Strehimit.z.Ledion Mullali, Përgjegjës i Sektorit Kulturë, Arte, Turizëm; z.Festim Tomorri

Ornildi Demollari:Mirëdita të gjithëve, të nderuar kolegë, i nderuar kryetari i bashkisë, të nderuar pjesëmarrës.Sikurse jemi njoftuar, fillojmë këtë mbledhje të radhës të Këshillit të Bashkisë Maliqit për muajin korrik dy mijë e njëzet e pesë.Besoj me materialet e mbledhjes, me njoftimin, njoftimin dhe materialet i keni marrë disa ditë përpara. Bëmë një verifikim të korumit, në sallë janë të pranishëm shtatëmbëdhjetë këshilltarë, realizohet korumi dhe mund të vijojmë me mbledhjen dhe me rendin e ditës.Vetëm do t'ju, do t'ju lutesha që të shtojmë edhe dy pika te rendi që keni marrë dhe jeni prezantuar. Kemi dakordësuar në kryesi që të shtojmë edhe dy materiale, një projektvendim dhe një tjetër informacion.

Ornildi Demollari:A jemi dakord me rendin e ditës, duke shtuar edhe këto dy materiale, një projektvendim Kush është dakord ? 18 vota pro
Kundër? Nuk ka.
Abstenim?Nuk ka.
Miratohet me 18vota pro. Faleminderit..

Petrit Kupe: Po, nuk e di mund ta shqyrtojmë që tani? Po, për dy pika të rendit të ditës, ne si komision kemi sugjeruar që krahas materialit të pregatitur për vlerësimin e pronave, kemi sugjeruar që të bëhet edhe një dëgjim në ato pjesë, në ato fshatra të cilat është pregatitur ky material. Ne diskutuam edhe ditën e djeshme. Është një dëgjim që i shërben qetësimit apo mos sensibilizimit të komunitetit që ka të bëjë në lidhje me pronat.Megjithëse ligji thotë që në rast tjetërsimi të pronave mund të bëhet dëgjesa, po përderisa ne kemi një ankesë nga komuniteti, nga fshati i veçantë e shtruan si sugjerim që të bëhet edhe kjo dëgjese dhe pastaj këto dy pika të shtohen në rendin e ditës për miratim. Kështu sygjuron komisioni.

Ornildi Demollari:Po, Petrit, faleminderit. Është fjala për pikën gjashtë dhe pikën shtatë dhe unë personalisht jam dakord dhe ia kërkoj që ato të zbriten nga rendi i ditës. Është ashtu sikurse e tha ju që ligji dhe rregullorja e përcakton qartë që këshilli, përpara se të marrë vendim, duhet të konsultohet me publikun për rastet kur tjetërsohet prona.Mesa di unë, në këtë rast, në pikën

gjashtë dhe në pikën shtatë, nuk jemi në këtë situatë, megjithatë, nëse ne këshilli konsultohet me publikun, nuk ka asgjë të keqe përveçse një gjë të mirë, kështu që edhe unë personalisht gjykoj që këto pika le të ngelen për një mbledhje tjetër, pas pasi të zhvillojmë një konsultim me publikun.Atëherë do desha po këtë.Po Kryetar.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Nuk e kuptoj, edhe ligji i thoni nuk e ka kështu, edhe donin ta shkelni. Në fakt, ne nuk po japim pronat njerëzve të tjerë, ne po bëjmë një përditësim të pronave në këto fshatra. Në qoftë se doni ta vononi, edhe me nja dy muaj të tjerë, është e drejta juaj.Mund ta hidhni poshtë. Vazhdon shumë faleminderit. Që për ta vazhduar, që mos e lë të thatë, nuk e di çfarë doni të arrini, pasi grupi komisioni do të shkojë me idenë për t'i përditësuar se ka probleme, në numra pasurie, se nuk jam dhe specialist i kësaj fushe, po drejtoria e pronave qoftë ashtu, Andi apo specialist mund t'jua shpjegoj.Qëllimi është përditësimi i pronave në këto zona, ku aty do të jenë edhe qytetarët, edhe në një farë mënyre ajo është edhe një pjesëmarrje e publikut për atë çfarë ne do të vendosim bashkërisht, domethënë bëhet një përditësim i këtyre pronave.Aty do të shkohet, është pare, nuk është se ne po i marrim pronat e këtyre zonave dhe po ia japim dikujt tjetër, s'ka të bëjë kjo.Vetëm në këto raste, ligji parashikon që ne s'mund t'i japim pronat pa bërë një dëgjim publik. Në fakt, nuk po kryejmë një gjë të tillë, po bëjmë vetëm rregullim, përditësim. Në qoftë se ka ndonjë, ndonjë merak nga anëtarët e këshillit, mund ta i thoni që di more përse bëhet fjalë, që se duhet të jemi të sinqertë me njeri, jo të hapur.

Ornildi Demollari:Kryetar, jemi përpara një kërkese që na ka hedhur nga banorët.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Jo, çfarë kërkojnë banorët? Këtë dua të di.

Ornildi Demollari:Na vë në një lloj, se ne nuk po ia marrim banorëve apo zonës, edhe pse nuk janë të tyre.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Nuk janë pronat e tyre, por po i përditësojnë për efekt të nevojave që mund të kenë vetë banorët apo të tjerë për t'i zhvilluar këto prona. Kjo është më pak fjala Megjithatë, është e drejta juaj, vendimarrja juaj ka këtë të drejtë, mund ta rrëzoni dhe mund t'i çoni prapë, por do ta vononi si procedurë kaq.

Faslli Zholi: Tashti, përsa i përket kësaj pike që ne po diskutojmë, unë ndodha die aty në atë komision ishte edhe drejtori i Andi, mbase nga ana ligjore, po kur ne shikojmë një kërkesë të qytetarëve që kanë bërë, besoj se nuk do të jetë kaq problem ta vonojmë me dhjetë ditë, të bëhet dëgjesa dhe ta miratojmë, sikur edhe në një mbledhje të jashtëzakonshme, siç kemi miratuar, kemi bërë herë të tjera.Faleminderit.

Yllson Ibrahimllari: Doni ta ezauroni tani diskutimin, apo doni që të presim radhën? Nëse keni rënë dakord për ta hequr nga rendi i ditës, më thoni pse ndodhen cilat argumenta që i shpjeguat, doni dëgjues publike etj.Nëse doni ta futni në rendin e ditës, atëherë më jepni hapësirën, duke qenë këshilltari i atij fshati, banor i atij fshati, për të cilin të paktën jo për Pirgun, për

Velçanin.T'ju jap argumentat e gjëndjes faktike në terren se ça ndodh aty, që të paktën edhe zyra të jetë e qartë edhe juve si këshilltarë të jeni të qartë, unë besoj që edhe një gjë tjetër, tashi kryetari ndërhyri.Ju thoni që momentalisht ligji nuk e, nuk ka përcaktim të tillë, por ka një përcaktim tjetër ligj në 131 çertifikata të ndara nga Komisioni i Ndarjes së Tokës në fshatin Velçan, në bazë të ligjit shtatëmijë e pesëqind e një, nëntëmbëdhjetë i shtati, një mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e një, njëqind e gjashtëmbëdhjetë persona nuk i kanë firmosur çertifikatat.Kanë kundërshtuar komisionin, nuk kanë pranuar të marrin tokën për efekt të bonitetit të tokës, për efektet të problemeve që kam pasur me pronarë, ish pronarë dhe të tjera, pra ka një specifik tjetër ky fshat për të vendosur.Ky fshat të paguar dhe shtrenjtë edhe në lëkurën time dhe në bashkëbisedimin me ju.Ka dhe një problem tjetër. Ka një ndërveshje, po të marrim tani dhe të hapim në Google automatikisht zonën kadastrale 3727.Zona katastrale tre dhe shtatë njëzetë e shtatë nga konfiguracioni në asig nuk e përmbledh gjithë fshatin Velçan lë një pjesë të madhe të pasurive të fshatit Velçan pa i futur.Nga të gjitha më të pëtë që unë mund t'ia vë në dispozicion, se kam të gjitha të fshatit, rezulton që një pjesë e banorëve i kanë dorëzuar këto dhe kanë bërë kontratë noteriale që nuk e duan tokën. Tani sot mund ta kërkojnë atë, duhet gjetur juridikisht edhe një klauzolë. Do t'iu regjistrohet këtyre apo jo? Kanë shkuar te hipoteka dhe kanë thënë atje sipër në kufi afër liqeneve. Ç'e doni atë tokën atje, është pa frut ajo. Mos e regjistro këtë parcelën e vogël dhe ne sot të gjitha këto toka. Këto toka na rezultojnë shtet, toka të patrajtuara, toka pa marrë.Ne kemi disa pasuri dhe thotë njëqind e shtatëmbëdhjetë pikë katër, nuk e di numrat se nuk i kam parë imtësisht tashi, po i kam parë para disa ditësh. Dhe thotë nga njëshi deri te shtata është regjistruar për banorë, po teta ngelet e lirë shtet dy mijë metra, përveçse ka diskordancë ndërmjet librit ngastrave. Ka diskordancë mbi AMT e fshatarëve. Ka gabime të kufijve për të ardhur dhe sigurisht, kjo është një iniciativë shumë e mirë e marrë nga zyra.Aq më mirë që kemi nivel të lartë specialistik tashmë të ardhur, por kemi një defekt në terren.Defekti në terren është që përveçse nuk dihet kufijtë e fshatrave, të paktën në zonën e Gorës të përcaktuara shkojmë dhe bëjmë Gent plane që i ka hartuar zyra dhe ndërkohë për ça na duhet kjo kryesia e fshatit ne dhe ky kryetari i fshatit, që nuk u thirr, nuk u thirr kërka edhe kur bëhen këto gent plane, se paskemi vajtur në vend. Atëherë, ne paskemi kaluar një hallkë, e dyta kemi një plan të mbarështrimit të të pyjeve të miratuar nga ky këshill, me vendimin tridhjetë e shtatë, e kemi biseduar dhe bashkë këtë çështje. Të cilat sot rezulton një mbivendosje e parcelave me zërin kadastral, pyll me parcelat tokë bujqësore. Atëherësh në të gjithë këtë këtë konglomerat, po mor ta bëjmë dhelçanin, si mos e bëjmë?Jam i gatshëm të kontribuoj dhe financiarisht mbi një shumë për të gjitha, problemi është që sot për ta vendosur dhe për të bërë Velçanin sot hartografikisht, duhen minimalisht në studio të pyetur nga unë, të paktën para disa vitesh, kur kisha ndërmend për ta bërë këtë punë për të zgjidhur hallet e mia, atëherë kostonte nga njëzet e pesë deri në tridhjetë mijë euro për të bërë gjithë atë. Dhe ne na vijnë tani dhjetë pasuri, kur ndërkohë Vëlçani sot ekzistojnë tridhjetë e shtatë pasuri shtet, pse të mos i bëjmë të gjitha këto pasuritë shtet? Ne i bëjmë mirë e mirë Vëlçanin dhe pastaj kalojmë me Dolanin, pastaj me Dusharin, pastaj me Moçanin.Pra, në këtë sens, çdo futje dorë e pjesshme mbi një gjë në të cilën është trazuar gjëja, duhet të jemi kujdes. Shikoj disa pjesë të kartelave dhe thotë pasuria shtatëqind e nëntëmbëdhjetë vjet.Pasuria shtatëqind e nëntëmbëdhjetë vjet që fillon nga shtatë, çdo shtatëqind e nëntëmbëdhjetë në Velçan, është ngastër pyjore, por e vërtetuar me planet e mbarështrimit sot të

ekonomisë pyjore Mesmal, nuk rezulton që të jetë pyll fare kjo pasuri ose diku tjetër, pra ne kemi këtu një gjë, të cilin e kam biseduar edhe me Zotin Lame, ndjesë pastër. Sepse shpesh herësh them, hartat janë ngatërruara, pronat janë ngatërruara, e shumë e vështirë këtu nuk na i zgjidh dot vetëm kryetari, me gjithë vullnetin e mire. Pronat e shqiptarëve nuk janë fare të ngatërruara. Pronat e shqiptarëve i dinë atje, i thotë guri i Çaushit, ara e verës, kufiri i Kupes, problemi është që i ngatërrojmë ne me letrat që mbajmë. Me hipotekë ka një gjë, Vilçani ka njëqind e tridhjetë ship, asnjë shpi s'ka tapi, asnjëra s'ka kufi, ne paguajmë trojet, paguajmë taksën për truallte te njësi administrative.Asnjë s'ka listë, s'ka listë të trojeve Velçani zero zero njëshi, si i quaj në formula. Ah, nëse do ta zgjidhim, po dhe e dyta. Unë jam banor juridikisht në Velçan, kam edhe një shpjegim me çertifikatë më në fund të lëshuar nga Andi mbrapa. E falenderoj për gjithë ndershmërinë e tij.Problemi është edhe në qoftë se ne do vendosim këto prona, t'i japim. Do të jemi shumë të kujdesshëm ku t'i japim në ç'sens?Jo juridikisht s'ka asgjë, s'kam asnjë dyshim fare në të gjitha përpjekjet e kudo dhe admiroj që këto prona duhen zgjidhur edhe për një arsye tjetër, se vitin që vjen shumica e heceve në zonën e Gorës kanë për të ripërtërirë kontratat e qerave dhe aq më mirë që t'i kemi të regjistruara këto pasuri të dimë ku kalojmë, ku bëhet edhe për të marrë ca fonde më shumë. Por duhet të kujdesemi që ai kushëri im që jeton në Velçan, apo ajo goca e xhajes tim që ka sot një tufë blegtorie diku te shtatëqind krerë, po ia dha Yllsonit ato me qera që do marri këto copat e s'do ta lërë t'i kullosi atje matanë ku janë ato, apo t'i mbjelli këto tokat. I bie që edhe ata ekonominë do t'ia coptojmë, edhe do bëhemi edhe kështu, një farë mënyre nxites për largimin e njerëzve që mezi jetojnë në ato anë, nisur prej kësaj, në qoftë se duhet të jemi seriozë, me Velçanin, me Vreshtasin, me Pirgun e tjerë. Kemi zyra dhe kapacitete kaq të mëdha në këtë bashki, kemi një numër goxha të konsiderueshëm, kemi vullnetin pozitiv të kryetarit. Përpara se të na vijë ndonjë shkresë, siç ka ardhur edhe një tjetër, të paktën për zonën time, sot nga Google për dhjetë minuta arrin t'i gjesh hartat, të jenë më serioz në bërjen e dokumentacionit dhe të hartës.Kemi dhe një konflikt tjetër në këto bërje. Para disa vitesh, kur është bërë regjistrimi fillestar, fatet e cilit po vuajmë në kurriz edhe sot, zoti Lame, krushku im dhe njeriu im i miqësisë familjare, që e keni këtu te grupi i punës ka qenë koordinator.Të lutem Vera, të lutem po flas, se pastaj më thua ça kishe. Zoti Lame, topografi i bashkisë aktualisht ka qenë koordinator për regjistrimin fillestar të kësaj zone, është konflikti i pastër interesi, nuk mund të hartojë planet e reja të rilevimit, ai që e ka pasur për detyrë për t'i hedhur ashtu siç duhesh.Të lutem, këtu ka pengesa ligjore dhe më e fundit që është dhe më e rëndësishme. Të gjithë kemi dijeni, ja keni dhënë dhe dorën, Yllsoni ka kaluar nga kjo rrugë dhe është në këtë këshill bashkika, me mandat të plotë, me qetësinë e nevojshme, me dashurinë e përkrahjen e gjithësecilit prej jush, për të realizuar së paku nëse s'e rregullon dot Maliqin, Vëlçanin do ta rregullojë.Besoj që gjithësecili nga këshilltarët e majtë në qoftë se do të kërkonte një ndihmë për të rregulluar Pojanin Lola, që mezi po pret, gati do ta kishte Yllsonin. Tani problemi qëndron këtu për t'i rënë shkurtër fare.Vëlçani është katastrofë dokumentare, ka gjithë problematikën, mos futni duart pa e ndarë mendjen se çfarë do bëni. Këtu ku jemi dhe ku diskutojmë, kemi nevojë, është apo s'është ligjor, ne shqyr që banorët paskër kanë filluar interesin për ta bërë, nuk na gjen asgjë më shumë të dëgjohem, çik më shumë se sakaq. Kanë ndodhur afishime publike, shkojnë regjistrohen pyje, gjoja i varim tek ato njësitë administrative, asgjë s'bëjnë, as marrin vesh ndonjë gjë, as unë, që në një farë mënyre i bie të jem çik teknik i mesëm topograf në ato

çfarë jam marrë kohët e fundit, edhe nga ortopedia. As unë s'i marr vesh ato harta se si i përgatitem. Të jemi të kujdesshëm të mos i bëjmë dhe e fundit fare dhe më e thjeshta, juridikisht e keni të pamundur për ta bërë këtë nisëm, meqë kaluam, kini një pengesë shumë të madhe juridike. Eshtë shprehur gjykata administrative e shkallës së parë.Dhe ka thënë, procesi përmirësim përditësimit i bërë për disa parcelat, që sot merr afërsisht tridhjetë familje bujqësore në Velçan, është jo i duhur, jo i saktë, jo i tillë. Për këtë arsye, ka kthyer mbrapsht procesin e përmirësimit të kadastrës Korçë. Do ishte mire, të paktën individualisht, unë s'kam asnjë cënim, as nga këto pronat, as nga ajo që ka bërë gjykata, është xhaxhai im në këtë mes. Do të ishte shumë mirë për të parë edhe këtë gjë, që gjykata është shprehur dhe vetë ASHK-ja e ka apeluar, Bashkia s'ka asnjë problem, ka dalë jashtë Gjykatës administrative, atëherë sot kemi tridhjetë familje bujqësore që presin vendimin dhe datën e shqyrtimit të apelit. Të pritet data e shqyrtimit të apelit dhe vazhdojnë me procedurat për regjistrimin tjetër, sepse këta tridhjetë familje kanë minimalisht nga pesë ngastra, të cilat dalin në disa prona edhe kufitarë te këtë gent planet e zotit Sulo, ju faleminderit.

Ornildi Demollari:Faleminderit.Po, kryetar.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Duhet të ndajmë disa gjëra. Sot kemi dy materiale në rend të ditës, që këshilli është i detyruar t'i marrë në konsideratë. Nuk mund t'i heq nga rendi i ditës. Mund t'i rruzoni, mund t'i nxirrni argumente nga më të ndryshmet. Ne nuk po diskutojmë këtu tokat bujqësore të familjeve bujqësore të asnjë fshati, pasi nuk ka më komision të ndarjes së tokës nëpër bashki, siç ka qenë më parë, nuk ka më, nuk ka mund të drejtë të jap tokë bujqësore. Ne kemi drejtë të përditësojmë prona të cilat i figurojnë shtetit, në qoftë se qytetarët kanë të drejta, ata le t'i kërkojnë, le t'i kërkojnë në kadastër, le t'i kërkojnë në gjykatë, kjo s'ka të bëjë me ne, drejtoria përkatëse e pronave, dhe nuk e ka me këshillin, e ka me ta. Kur fut një material në këshillë, të jetë e bindur që e fut ligjërisht për ta zgjidhur apo për të lehtësuar edhe familjarët, në qoftë se kërkojnë të marrin nga këto toka, që ndoshta mund t'i kenë refuzuar para tridhjetë vjetësh, kujt unë për një qëllim apo për një tjetër dhe duan të marrin pjesë për t'i zhvilluar, për t'i bërë dhe unë s'kam asnjë kundërshtim. Dhe nga ana tjetër, drejtoria e pronave do të vijë duke sqaruar juridikisht çdo element. se as unë, as këshilltarët, nuk e kanë këtë të drejtë, ose nuk e kanë këtë bagazhin e duhur, se mund të gabojnë, se edhe nuk mbajnë përgjegjësi për ato që thonë dhe që shprehin, për të na thënë që qëllimi është i mirë për t'i përditësuar, për t'i regjistruar, në qoftë se këshilli nuk është i bindur për këtë punë, e rrëzon me votë dhe kjo është e zgjidhur. Unë s'kam asnjë gjë për të gjithë të dyja materialet, nuk e di përse bëhet fjalë. Di që do të përditësojë, po bëhet kaq marrë një nismë pozitive nga drejtoria e pronave për t'i vënë në ullinjtë e ligjit dhe për t'i përdorur dhe për t'i futur për t'i zhvilluar si zona dhe këtu s'ka asnjë gjë të keqe, në qoftë se ju e mendoni që ore, hajt të pyesim dhe banorët, po ç'a thonë të nxjerrim me banorët?Banorët kërkojnë prona, që ndoshta u është ndërruar mendja se duan t'i marrin prapë, nuk i marrin dot. Nuk i marrin dot me këtë, i marrin me gjyq, ose në qoftë se kanë letra, që kadastra ja u njeh. edhe kjo s'është për t'i mbushur mendjen njëri-tjetrit. Në qoftë se ajo është i bindur që juridikisht i takon, vetëm hedh në gjyq kadastrën, hedh bashkinë, kujton, hedh komisionin e ndarjes tokave, etjera, etjera. Po me ne s'ka lidhje, ne flasim për prona që me vendim qeverie na janë dhënë

ne.Të më korrigjojë drejtoria e pronave dhe thonë, pronë shtet, pronar është bashkia, bashkia do t'i përditësojë për të nxjerrë të ardhura, që të marrin ata njerëz që janë atje ndoshta, apo të tjerë që duan t'i zhvillojnë, të bëjnë. Tani po derdhe paketë e maleve, është miratuar ligji, pse mos zhvillohen? Edhe kjo është me pak fjalë, në qoftë se ju doni kohë juridikisht apo edhe nga drejtoria e pronave, që të jeni të bindur për votën tuaj.Kjo s'përbën asnjë gjë të keqe, as për ne. Kështu që nuk është se ne po themi, ju futini, po miratojni, jo më gjykoheni si ta mendoni.Nuk doni, doni ta rrëzoni, doni informacion shtesë, doni, po nuk e di ç'të nxirrni në takim me banorët, banorët nuk kanë të drejtë mbi prona që s'janë të tyre. Mund të shprehin ide, mund të njihen me këtë informacion që edhe ata të bëhen pale në thonjëza e mirë që të marrin prona në atë zonë për t'i zhvilluar, dhe ku ka mirë që ata t'i marrin, se nuk besoj të vijë ndonjë nga Maliqi në Velçan për t'i zhvilluar, apo banorët që janë larguar dhe kanë një ndjesi udhëhimëse të ajo zonë për ta zhvilluar. Unë kaq kisha, megjithatë, këshilli le ta vendosë vetë.Do që ta shtyjë, se do të marrë disa gjë le ta bëjë, por juridikisht nuk është se kërkohet, se ne nuk po ia japim njeriu. Momenti kur ne do të shprehim se do të vijmë me një vendimarrje tjetër, që këto prona duam t'i nxjerrim për t'i dhënë me qira, vërtetë e tjera. Atëherë ju kemi drejtë, po, do bëjmë gjest publike që ata njerëz t'i shikojnë, mos kaloj kalimthi si ato varjet që tha, doktori që ndoshta si shikon njeri dhe t'u thuhet ore kini interes, po bëhuni palë, merreni ju ikni në derë e shtëpisë. Shumë faleminderit

Yllson Ibrahimllari: Problemi qëndron që këto prona dalin të regjistruara si shtet për arsye sepse hipot, sepse ça kemi sot vetëm për të sqaruar. Sot kemi një mbajtës të një AMTPE-je, të cilit grafikisht nuk i janë hedhur pronat në hartë. Po pra, dhe del e regjistruar shtet atje. Por, por, ne do t'i japim token, ne do të bëjmë çertifikatë për parcelën X si pronë shtetërore dhe do na vijë kartela si shtet, kur ndërkohë ajo është një nga rreshtat e AMTP të Pranvera Begollit. Si do ta bëjmë pastaj?

Ornildi Demollari:Po Andi, Andi të lutem.

Drejtori i Pronave Publike dhe Aseteve:z.Johand Sula: Përshëndetje atëherë të gjithëve në sqarim dhe të asaj çfarë është kërkuar nga këshilltarët dhe nga banorët e fshatit Velçan, duam të sqarojmë diçka, e para e punës e fillojmë nga titulli i pronësisë dhe titulli i pronësisë për këto prona nuk është thjesht prona të quajtura shtet, janë prona të cilët, me vendim të Këshillit të Ministrave, në varësi të viteve përkatës, dy mijë e dymbëdhjetë dhe dy mijë e dhjetë, i kanë kaluar bashkisë.Pra, një parantezë doktor që të të shpjegojë vetëm diçka, që jo çdo pronë është shtet, është pronë në të cilën ne po kërkojmë ta marrim, sepse shteti është koncepti i përgjithshëm i atyre pronave të cilat kanë mbetur, po themi, pa pronarë, qoftë edhe të individëve, siç e përmendët ju. Në rastin konkret, ne kemi pronë me një vkm të përcaktuar, si dhe me një inventar të përcaktuar.Aktualisht jemi duke kërkuar çertifikatën e pronësisë dhe bërjen e përmirësimit për ditësimit për këto pasuri. Pasi këto pasuri janë të paçertifikuara dhe nuk është çertifikata, këtë jam munduar të shpjegoj dhe dje, nuk është çertifikata titulli i pronësisë. Çertifikata është dokumenti i cili u bën me dije të tretëve që kjo pronë është e dikujt, ka pronar dhe ky është dokumenti me të cilin ti do shkosh të paraqitesh në çdo institucion, qoftë edhe përballë noterit, për të bërë po themi dhënien me qira apo një veprim tjetër me këto prona.

Prandaj, në rastin konkret, ne thjesht po çertifikojmë dhe po saktësojmë pronat që i përkasin bashkisë, përsa i përket pjesës të dëgjesës, Kryetari e përmendi shumë mirë, besoj dhe unë, mbase nuk kam qenë i qartë të dije në komision, dëgjesa publike do bëhet në momentin kur ne këto prona do t'i nxjerrim, qoftë për dhënie me qira apo qoftë për tjetërsim, siç e ka të përcaktuar edhe ligjinë nenin pesëdhjetë e katër të tij, pika e, përsa i përket dëgjesës publike për marrjen e çertifikatave nuk rezulton dhe nuk ndryshon asgjë më tepër nga ajo që shpjegoi kryetari.

Yllson Ibrahimllari:Që të mos zgjatemi më, sepse është e gjithë, jo, jo, është pyetje me zotërinë, se s'mund të vazhdojmë kështu pambarimisht me këtë temë.Janë po themi, janë regjistruar të gjitha pronat, siç po thotë Andi, tek kjo lista ka një VKM për transferimin e pronave në varësi të bashkisë të komunës Gorë. Të gjitha ato prona janë të listuara tek kjo?

Drejtori i Pronave Publike dhe Aseteve:z.Johand Sula: Të gjitha pronat janë të listuara.

Yllson Ibrahimllari: Atëherë të lutem shumë, para dy muajsh kemi dhënë ndihmë për një familje në mesmal, përsa i përket djegies nga zjarri fatkeqësi natyrore kemi miratuar si këshillë. A mund të m'i regjistrosh të gjitha shpitë e Velçanit, se do t'i sigurojë që t'i marrin siguracionet nga tërmetet ose nga zjarret?

Drejtori i Pronave Publike dhe Aseteve:z.Johand Sula: Patjetër.

Yllson Ibrahimllari: E ke listën, po e gjej formularin zero një. Të lutem, këtu flet teknikisht me mua.

Drejtori i Pronave Publike dhe Aseteve:z.Johand Sula: Të lutem, teknikisht pra, për të gjitha ato pasuri që nuk kanë VKM-në katërqind e tridhjetë e dy apo listën zero një, që quhet qeveria në dy mijë e njëzetën, ka nxjerrë një VKM, është VKM-ja tetëqind e njëzetë e shtatë, është lehtësisht e aksesshme, ku qytetari paguan dhjetë mijë lekë të reja dhe merret posaçërisht hipoteka me regjistrimin e çdo trualli në funksion të ndërtimit dhe për rastin konkret, për Velçanin mund t'i drejtohem e-Albnia nëpërmjet këtij shërbimi dhe automatikisht brenda afateve kohore të përcaktuara që ka SHK-ja për kryerjen e kësaj pune, do pajisen me çertifikat pronësie. Nuk është një detyrë që e ka bashkia për ta për ta bërë.

Ornildi Demollari:Mirë, faleminderit.Po.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Është është një proces, jo vetëm këtë, mund të kemi projektvendime të tjera në vazhdimësi, se besoj nuk janë vetëm Velçani dhe edhe Pirgu. Ne duam që zyra e pronave, siç ka filluar, të vërë në pozita ligjore çdo lloj pronë, e cila ende ka probleme me ne, me bashkinë, jo me qytetarët. Qytetarët mund të na drejtohen, mund të kërkojmë prona prej nesh, ne jemi të gatshëm t'i hapim, t'i shpallim, dhe kaq është me pak fjalë.

Drejtori i Pronave Publike dhe Aseteve:z.Johand Sula: Atëherë rasti, rasti i kësaj radhe, nuk është rasti i parë që ne po kërkojmë të, po kërkojmë pajisjen me çertifikata pronësie. Ne kaluam gjithë ato pasuri në vreshtas dhe nuk pati kaq problematik. E vetmja arsye që ne po ngulim në këmbë nuk është kur thotë kryetari, sepse na intereson në mënyrë personale apo në thonjëza për ndonjë përfitim tjetër, e kemi thjesht që kjo gjë të mos bëhet precedent për çdo fshat, sepse dhënia apo marrja e çertifikatës së pronësisë nga ana e bashkisë për pronat e veta thjesht do na shtyjë afatin e pregatitjes të këtij dokumentacioni për t'u ndodhur sa më pranë qytetarëve. Përveç kësaj, ne jemi duke bërë edhe një database, i cili do publikohet edhe në faqen e bashkisë, që do jetë i aksesshëm për këdo që ka mundësi dhe e përdor faqen e bashkisë me të gjitha pasuritë për të cilat ne po çertifikohemi.Sot në mëngjes kemi patur fatin e mirë që nga ai projekt që kaluam radhën e parë së bashku, janë dhënë deri tani gati pesë çefikata dhe kur po vija për këtu, ishin tre çertifikata të tjera që na ishin miratuar nga ASHK-ja. Faleminderit, thotë kështu.

Ornildi Demollari:Pranvera, pranvera po.

Pranvera Begolli: Aktualisht do të thoja atë që Andi e përsëriti, pra, në mbledhjen e parë, ne miratuam për në Vreshtas e nuk e kishte problem, problem që komisioni e quajti për të mos i vënë në këtë, po t'i lemë në një mbledhje tjetër, sikur dhe jashtë radhë ishte thjesht sepse kishim një ankesë dhe kërkesë nga banorët e asaj zone, jo thjesht sepse ligji e lejon. Ligji e lejon kur dëgjesa do bëhet kur do jepet e gjitha kryetarit. Pra, meqënëse këtë radhë ne kishim një kërkesë nga banorët, në këtë moment e menduam të bëhet si komision, vendos të bëhet dëgjesa para se të bëhet dhe në një mbledhje jashtë radhë, ne fare mirë, domethëm, lamë një afat dhjetë ditorKështu e menduam të arsyeshme dhe në një mbledhje jashtë radhe mund t'i miratojmë këto dy.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Edhe diçka tjetër moj, që duhet të ndajmë një gjë, çfarë do të arrijmë me një dëgjese publike me banorët për këtë qëllim? Se ky është qëllimi, se ne nuk po i japim njeri pronat, ne po bëjmë anën dokumentare për t'i regjistruar, për t'i përditësuar, të më korrigjojë.

Faslli Zholi: Qyetarët pretendojnë se kanë dokumenta dhe nuk është regjistruar.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Po jo, shiko, po të bëjmë dëgjesë, po të bëjmë dëgjesa të tilla në çdo fshat, Ne nuk dalim dot, pse në fshat Maliq? Pronat që kemi rrëzë fshat Maliqit, banorët nuk pranuan t'i regjistronin, tani u është ndërruar mendja, po s'ia jep njeri.Unë e dëgjova me kujdes doktorin, tha, i gënjyen ca që tha ç'i doni atje n'liqeni, po tani liqenit i ka ardhur radha, se do të zhvillohet atëherë këta banorë kanë interes, shumë mirë që kanë interes, dhe inshallah i marrin ata, por nuk i kanë pronat e tyre.Patjetër, patjetër ai po pandaj, pandaj, pandaj ai në qoftë se ka një dokument, hedh kadastër në gjyq, hedh veten në gjyq edhe kur e shikon që ia ka futur bashkia në thonjëza, na hidh edhe në gjyq. Apo na thërret?

Yllson Ibrahimllari: Në protokoll i ke, o kryetar, kanë ardhur në tetëmbëdhjetë, i dymbëdhjetë, i dy mijë e nëntëmbëdhjetë.Ke një njëzet ankesa aty.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Po nuk janë marrë në konsideratë pra se varen si i kanë bërë ankesa, po pra ankesa, drejtori e pronave që e ka detyrë ligjore. Duhet t'u kthej përgjigje që sa të drejtë kanë, ose t'i drejtoj thotë drejtorin e gjykatës, se për ne nuk qëndron, ata mund të kenë të drejtë, po gjykata moj.

Yllson Ibrahimllari: O të lutem, për të rregulluar shtratin e lumit, i çuam shkresë. Akëpesë i çuan dhe ministrisë, pra kjo zyrë nuk e kishte mundësi ta vinte shtatin e lumit atje ku bie faktikisht që e vërtetuan dhe vetë djemtë.Të lutem, e dimë, e dimë, e dimë shumë mire, e dimë këtë, edhe dimë edhe të tjerat. Tani për të rregulluar të gjitha pronat, që aty do dalin, do dalin. Pse duhet ajo dëgjesa? Do dalin me çertifikatat vjetra pronësie dhe do thotë.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Doktor, ne edhe të ketë çertifikatë në dorë, nuk i zgjidhim dot gjë, ia zgjedhë kadastra.

Yllson Ibrahimllari: Të lutem, mund të dëgjosh apo jo?Të lutem, kemi njëqind e tridhjetë e dy amtp.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Po.

Yllson Ibrahimllari: Kemi kemi njëqind e tridhjetë e dy AMTP.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Po le të vijnë ti i marrin o tek keni qëndrimi i katërt në kadastër

Yllson Ibrahimllari: Jo moj, ka kjo zyra për detyrim.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Po çfarë i bën zyra ore?Zyra s'ka, pasi nuk ka më komision të ndarjes së tokës nëpër bashki, është shkrirë, nuk ka më.

Andonaq Risto: Kryetar, më fal.

Ornildi Demollari:Po, Andon, aq edhe të lutem.

Andonaq Risto: Sepse po dëgjojmë dhe po dëgjojmë. Unë personalisht kam të njëjtin problem vetë dhe e kam ndjekur, dhe rruga është kjo, se kam vajtur në hipotekë dhe i kam marrë. Në vitin një mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy, në NB Plasë, ne kemi blerë një truall. me noterime të gjitha do e kemi blerë, mirëpo nuk janë regjistruar në atë kohë që duheshin regjistruar dhe për shkak.të kësaj, në këto momente, unë i plotësova dokumentat, ta regjistroja dhe më thotë hipoteka që unë duhet të paguaj tre milionë lekë që ta regjistrojë dhe e regjistron, dhe nuk ke asnjë lloj problemi. Në vitin 2020, shteti miratoi një ligj dhe mund ta regjistroje falas, siç tha edhe drejtori Andi. Mirëpo, në atë kohë unë nuk vajta dhe nuk e bëra, në këto kushte regjistrohen të gjitha prona në qoftë se ke një dokument, por thjesht duhet të paguash tre milionë

lekë gjobë për mosregjistrimin e tokës tënde që ke ti në qoftë se ke dokument, po në qoftë se nuk ke dokument, këtë tokë nuk e merr dot, sepse ne unë mund të them dhe aq se kam një vend aty, është shtet dhe është timja. Po, por s'ke dokument, si mund ta marrësh, se këtë s'më kuptoj. Por unë po ta them që unë e kam ndjekur deri në një dhe i kam plotësuar të gjitha dokumentat, vajta për të në i dorëzova me shitblerje, me i bëra me harta treguese me të gjitha dhe më tha do paguash tre milionë gjobë, që kjo trokë të regjistrohet, sepse kështu është ligji.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Dhe diçka të fundit që ta mbyllim, si unë nuk kam asnjë. Ne nuk kemi asnjë gjë që të vemi t'i takojmë ato komunitete atje për probleme që mund të kenë.S'kam asnjë gjë, domethënë jemi mund të ecim në ndonjë linjë që komisioni apo këshilli apo kryesia kanë vendosur që t'i dëgjojmë. S'ka asnjë gjë të keqe, të marrin dhe shqetësimet e tyre, t'i marrin për t'i çuar. Por unë në konceptin tim them, nuk u zgjidhim gjë. Që t'i begenisim, të shkojmë atje, hajde të vemi. Të vejë zyra e pronave, drejtoria e pronave, t'ju thotë çfarë dokumenta ke dhe t'ju japin një mendje si duhet të veprojnë. Kjo është mendja ime, nuk e di.

Drejtori i Pronave Publike dhe Aseteve:z.Johand Sula: Atëherë, e fundit, e fundit, më falni, ju lutem, më falni, meqënëse fillova, më fal.Në mbështetje të asaj që tha kryetari, m'u duk sikur ma lexoi mendimin, meqënëse unë e kam fatin e mirë që kam punuar në atë institucion, nuk përtoj të ofrohem për të sqaruar në çdo fshat. Le ta organizojnë si të duan dhe të më caktojnë një ditë, nuk përtoj për t'i sqaruar gjithësecilit. Por të paktën këshilltarët këtu dhe doktori në veçanti duhet të kuptojnë diçka, që pavarësisht se ne themi drejtoria e pronave.Drejtoria e pronave, kryesisht, është për pronat që i përkasin bashkisë. Jo se ne nuk mund t'i sqarojmë qytetarët, jo se nuk mund t'i ndihmojmë me konsulencë. Po përveç kësaj, nuk kemi tagrin ligjor për të për t'i pajisur me dokument, pronësi apo për t'u dhënë diçka. Mund t'i ndihmojmë me konsulencë, me çfarë ata e shikojnë të arsyeshme për të bërë.

Ornildi Demollari:Po Petrit.

Petrit Kupe: Më duket se mbas atij ai diskutimi më duket edhe kryetari ra dakord që komuniteti dëgjohet dhe besoj se të dëgjohet sa më parë dhe qëllimi është mos vonohet miratimi për vendimin, është sugjeruar që takimet të bëhen në një datë të shpejtë dhe të paraqiten sa më shpejtë në mbledhjen e këshillit.Besoj se ky takim do t'i shërbejë edhe asaj që tha drejtori i pronarit të bashkisë, ata kanë nevojë edhe për sqarime të tjera, kështu që ky takim është i vlefshëm dhe duhet të zhvillohet.

Almir Elezi: Kryetar, një pyetje informuese desha më shumë, fshatarë që kanë investuar në stalla ose në pemëtari në toka shtetësi, do veprohet në këtë rast? Kanë të drejtë t'i kërkojnë me qera apo?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Drejtoria e pronave në prona që janë shtet, pas kërkesës dhe pas konkurrimit që mundohen mbas ligjit në fuqi, ka drejtë ta marrë me qira sipas numrave të pasurive që ne figurojmë, edhe pse kemi disa problematika në numër pasurie që ndonjëherë

janë mbledhur, thonë numri i pasurisë 150 edhe ka tetëdhjetë hektar, ai mund të ketë një stallë dhe nuk e merr dot. Kemi kërkuar dhe po ecim në linjën për t'i përditësuar dhe këto numër pasurie për t'i bërë me akte rilevimi më të vogla, që mos e marrë një person, po ta marrin shumë persona dhe t'u shërbejë, po them shumë raste, se rasti thënë të mund të jetë specifike dhe duhet parë. Konkretisht me drejtorinë e pronave, e njëjta gjë, meqenëse unë të njoh personalisht dhe flitet për zonën e Podgories, ne po ecim në atë linjë aty, vërtetë ka probleme që kur janë regjistruar pronat nga ish-komunat, i kanë futur në një numër gjithë malin, gjithë korijen, edhe qind e gjashtëdhjetë hektar. dhe kjo krijon probleme për t'ia dhënë një personi i cili ka marrë pesëqind metra apo dy dynyma. Edhe po shikoj nga drejtoria dhe po ju sjellim në këshillë edhe përditësime për t'i çuar në qeveri, për t'i marrë me fraksion numër pasurie, që të kemi mundësi të japim sa më shumë dhe ta zhvillojmë zonën.

Ornildi Demollari:Andi kishe gjë këtu?

Drejtori i Pronave Publike dhe Aseteve:z.Johand Sula: Atëherë për në ndihmën e këshilltarit. Është ajo që unë sapo thashë më lart, që jo çdo pronë në shtet është pasuri që i përket bashkisë. Prandaj, ne jemi duke ngulmuar dhe duke punuar fuqishëm për pajisjet me çelësat pronësie për këto pasuri, të cilat i kemi të aksesshme për të gjithë qytetarët që kanë nevoja realisht dhe duan që t'i zhvillojnë apo të ecin në këtë drejtim.Faleminderit.

Yllson Ibrahimllari: Andi, hiqe nga fjalori jot të paktën faktin që pronat e bashkisë dhe pronat shtet të bashkisë, pronari i pronave të njësisë territoriale që po flasim është këshilli bashkiak, bashkia është ekzekutivi. Fakti që kemi këtu një komision dhe ai zotëria është kryetari i komisionit të financës të pronave.

Drejtori i Pronave Publike dhe Aseteve:z.Johand Sula: Dhe ke gabim, doktor. Më fal, nuk dua të replikoj.

Yllson Ibrahimllari: Po sigurisht, po pra, nga trupa ekzekutive dhe kështu. Pse i sjell për t'i miratuar tek ne nëse ne s'paskemi vlerë në argument? Ju faleminderit.

Ornildi Demollari:Është, është i saktë kryetari koleg. Në qoftë se hyjmë në diskutime, ne apo ju, kjo është diskutimi më bosh. Dakord. atëherë ju lutem, miratuam rendin e ditës, duke mos i zbritur dy pikat, kur të arrijmë tek pikat në, e ke miratuar të plotë rendin ditës.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Ju lutem, të ndajmë një gjë, nuk mund të hiqet nga rendi i ditës një projektvendim i sjellë nga kryetari i bashkisë apo nga zyrat, ai mund të rrëzohet, po po, ai rrëzohet, pse nuk i mbushet mendja këshillit, po jo ta hiq nga rendi i ditës.

Ornildi Demollari:Kemi, kemi miratuar rendin e ditës me shtatëmbëdhjetë vota pro, ecim me rendin e ditës, ju lutem se u zgjatëm goxha.tek pika e parë, ju lutem dua tju ju njoh me vendimet e mbledhjes së kaluar.Të cilat janë gjithsej shtatëmbëdhjetë vendime, të cilat janë konfirmuar

edhe nga Prefekti i Qarkut. Nga të cilat nëntë me karakter normativ dhe tetë me karakter kolektiv, ju i keni marrë, besoj s'ka nevojë t'jau, t'jau përcjell, t'jau lexoj. Ju ftoj, kalojmë tek pika e dytë, deklarimi i konfliktit të interesit nga këshilltarët për vendimarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës. Nëse ndonjëri nga kolegët ka konflikt interesi me ndonjërën nga pikat e renditës, është mirë që të mos përfshihet në atë pikë, as në diskutim, as në votim. Kalojmë tek pika e tretë e rendit të ditës, miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës tridhjetë e gjashtë të dy mijë e njëzet e pesë. Ju lutem, miratojmë procesverbalin e mbledhjes së kaluar.

Kush është dakord me protokollin ? 18 vota pro
Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet. Me 18 vota pro. Faleminderit.

Ornildi Demollari:Kalojmë tek pika e katërt e rendit të ditës, projekt vendim për miratimin. Ju lutem, ju lutem. Projektvendim për miratimin e përfituesve nga programi i subvencionit të interesave të kredisë për strehimin. Kush e do fjalën, komisioni përkatës Idlir?

Idlir Limllari: Nuk asgjë, një rast që kërkon kredi të butë një person i ndarë i divorcuar. S'ka problem.

Ornildi Demollari:Zyra përkatëse kishe gjë? Ledion urdhëro?

Faslli Zholi: Unë se isha në komision, diskutuam për atë familjen, po vërejtje dhe për Idlirin, duhet të mblidhemi si Komision. Duhet t'i shikojmë t'i japim përparësi, sepse kemi ngritur disa herë komisionet nuk funksionojnë siç duhet të funksionojë. Faleminderit.

Ornildi Demollari:Po i bashkohem thirrjes së nënkryetarit, është shumë e rëndësishme. Ngelemi, duke bërë thirrje, thirrje pas thirrje, thirrje pas thirrje.

Idlir Limllari: Është situatë e ngarkuar faktikisht.

Ornildi Demollari:Këtë angazhim që kemi marrë është mirë që ta përmbushim maksimalisht në sekondë.

Përgjegjës i Zyrës të Strehimit.z.Ledion Mullalli: Po, në fakt, kjo është një procedurë standarde që ne po e ndjekim gati në çdo mbledhje të Këshillit Bashkiak dhe jemi të lumtur që po trajtojmë çdo, gati çdo muaj, nga një familje me kreditë të butë. Do t'i bëja thirrje edhe familjeve të cilat kanë nevojë për të blerë një banesë dhe nuk kanë patur banesë në pronësi gjatë pesëvjeçarit të fundit, ashtu siç e parashikon edhe ligji, të interesohen pranë bashkisë me ligj, të marrin çdo informacion të mundshëm për dokumentacionin dhe procedurat që ndiqen për të aplikuar dhe për të përfituar nga kjo nga ky program strehim.

Ornildi Demollari:Aktualisht ne kemi kuota apo jo?

Përgjegjës i Zyrës të Strehimit.z.Ledion Mullalli:Aktualisht ne kemi kuota për të trajtuar familje, kemi rreth njëzet kuota për të trajtuar, sepse edhe kërkesat kanë qenë të ulta dhe do jemi të kënaqur që të trajtojmë.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Unë, unë mendoj që ka një çik mungesë informimi në këtë pjesë dhe le të jetë ky një apel, po normalisht edhe ju si zyrë, por dhe njësitë administrative, ndoshta këshilltarët, kryetarët e fshatrave, duhet të jenë shumë më afër njerëzve, duke e ditur që kanë probleme me strehimin, se mos bëhen dhe ata pjesë apo ndërmjetësues nga më të mirët që t'i sjellin dhe ta përfitojnë, se një shpi ta përfitosh me kushte favorizuese me këtë program që qeveria jep edhe me përqindje shumë të ulët, do ishte shumë e mirë për familjet e reja, por dhe për familjet tjera që nuk janë pak në territorin e bashkisë. Por ndoshta ka një mungesë informacioni, le të jetë ky një apel për të gjithë dhe le të jemi bashkërisht në këtë për të për t'i orientuar qytetarët për të sjellë për për të bërë aplikimet e duhura.

Përgjegjës i Zyrës të Strehimit.z.Ledion Mullalli:Po dhe diçka tjetër, ne në fillim të vitit dhe në mes të vitit e kemi bërë praktikë tashmë që bëjmë thirrje për aplikim në të gjithë stendat e bashkisë dhe të njësive administrative dhe në faqen zyrtare të bashkisë Maliq, është thirrja në të cilën është dhënë i gjithë informacioni i duhur, për kushtet e përfitimit për dokumentacionin e kërkuar dhe se sa përfiton çdo familje në bazë të kategorive dhe përbërjes familjare që ka. Ndoshta do të jetë edhe ndonjë e nevojshme një bashkëpunim me median për të dhënë ndonjë informacion, kemi dhënë shpesh herë edhe informacione, por ndonjëherë duhen edhe përditësuar informacionet për të bërë ndoshta një emision, që të japim informacion dhe për programet e tjera të strehimit, por dhe për këtë program, i cili është shumë i dobishëm për familjet, është një kredi e butë me tre për qind, i vjen në ndihmë sidomos familjeve të reja për të blerë një banesë në territorin e Bashkisë Maliq.

Ornildi Demollari:Faleminderit, po Idlir.

Idlir Limllari: Tani kjo është më shumë gjysma e fshatrave, janë bosh. Të blejë një shtëpi të re në fshat, mua më duket. Ato kreditë shkojnë në qytete, në qytete të tjera. Nuk është problemi, se nuk kanë informuar. Gjysmat e fshatrave janë bosh, shpitë janë bosh. Kaq ishin.

Ornildi Demollari:Faleminderit, kalojmë votim? Atëherë ju lutem,

Kush është dakord ? 19 vota pro
Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet. Me 19 vota pro. Faleminderit. Kalojmë tek pika pesë e rendit të ditës. . P-V"Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB-në nr.129, datë 26.12.2024, "*Për miratimin e numurit të*

punonjësve, nivelin e pagave të administratës së bashkisë Maliq dhe strukturave të tjera, për vitin 2025". Komisioni.

Petrit Kupe:Për këtë projekt mendim, komisioni sugjeroj të jetë dakord. Të dy ndryshime në strukturën e administratës së bashkisë dhe një në strukturën e agjensisë mbështetëse.Aty shpjegohet edhe një relacion, shtohet për efekt të menaxhimit të punëve të kabinetit të kryetarit, do të në pozicion të zbatohet dispozita e kodit të punës, por gjithashtu edhe në sektorin mekanik, për të përmirësuar punën e mëtejshme të ngarkisë që ka kjo agjensi në menaxhimin e mekanikës, ne jemi dakord.

Ornildi Demollari:Komisioni është okej, ka ndonjë gjë tjetër> ndonjë koment tjetër? Kryetar, do shtosh?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Po dy momente në lidhje me momentin e parë për drejtorin e kabinetit ka të bëjë edhe me ndryshimet e fundit, të cilat ne kemi ka ndonjëherë domosdoshmëri për efekt të lëvizjeve strukturore që pësojnë administratat, strukturat tona, edhe drejtori i kabinetit në një farë mënyre, që e kanë gjithë bashkitë, po unë e kam parë të arsyeshme për ta ndarë si detyrë me funksione të tjera, po po e shikoj që është e domosdoshme. Është për herë të parë që e kemi patur kohë më parë, po e kemi hequr me idenë që kemi mbuluar vetë, e shikoj që është e domosdoshme, kurse përgjegjësi i sektorit mekanik është vetëm njësim pagë, se ne e kemi si funksion, por nuk është i njëjtë me pagat e funksioneve të tjera që kanë përgjegjësat e sektorëve të tjerë dhe po një bëjmë njësoj në page. Ne për të qënë të hapur mund të kemi nevojë edhe për një përgjegjës të tjerë, por e kemi shumë të domosdoshme për ndjekjen e investimeve në terren. Nuk kemi gjë të tillë dhe po e ndjejmë domosdoshmëri dhe ndoshta kështilli mund ta shikojë të domosdoshme gjithë investimet që ne realizojmë në territor, edhe pse ndiqen nga mbikëqyrës, nga kolaudatorë që janë jashtë strukturave tona, por fitojnë në mënyrë me prokurime të drejtpërdrejtë me prokurime të shpallura, të hapura nga institucioni jonë, po përgjegjësia nuk është tamam siç mund të jetë kur ndiqet nga instruktura jonë. Ne, edhe pse kemi dy elementë, një një inxhinier dhe një ekonomist, nuk kemi një përgjegjës të këtij sektori, i cili do bënte të mundur ta kontrollonte të merrte kontratën e zbatimit, të merrte preventivin përkatës 0, edhe ta ndiqte çdo ditë këtë punë në terren. Punët që ne kryejmë janë të shumta, edhe ishte një domosdoshmëri, po e ndjejmë shumë të domosdoshme. Mund ta kalojmë, të kërkonim miratimin tuaj sot, ose mund ta lëmë në fund të vitit, kur të, kur të, se po, po punojnë për një ristrukturim të të gjithë administratës së bashkisë na ka ardhur një strukturë bazë nga institucioni që mbulon statusin e nëpunësit civil.Po bëhet një njësim i të gjithë strukturave të të gjithë bashkive, në varësi edhe të peshës që ato kanë, apo të përbërjes në varësi sa kanë bujqësi, sa blegtori, sa pyje, apo sa janë zhvillim urban, sa rural, edhe ne në këtë periudhë po punojmë që fillimi i vitit të kemi një strukturë të rehabilituar apo të ristrukturuar plotësisht, pothuajse. Shumë faleminderit.

Ornildi Demollari: Faleminderit, zoti kryetar. Ka gjë tjetër?

Yllson Ibrahimllari:Për këtë që sapo ndërhyri kryetari, unë besoj që është e domosdoshme edhe ta vendosim që sot këtë pjesën e mbikëqyrësit të investimeve edhe për një arsye tjetër, se bashkia

jonë i ka dhe si numra tërës këto me gjithë drejtorin e kabinetit, le të shkojmë me gjashtëqind e tridhjetë e një, se është dhe shanc.Por të paktën kur të na sjellin ndonjë produkt, ta sjellim produkt. Faleminderit,

Ornildi Demollari: Faleminderit. E kalojmë votimin? Ju lutem.

Kush është dakord ? 19 vota pro
Kundër? Nuk ka.
Abstenim, Nuk ka.
Miratohet. Me 19 vota pro.Me shtesën. Faleminderit. Tani arrijmë tek pika gjashtë e rendit të ditës, kur dua t'ju kujtoj që për këto dy pika ka erdhur një kërkesë. Ajo që e diskutuam po për ta prezantuar edhe për qytetarët, ku thotë drejtuar Këshillit Bashkiak, drejtuar Komisionit të Financave të Buxhetit Pasurive Bashkiake dhe Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Mbikëqyrës Financiare, subjekti pjesëmarrje në konsultim publik, Për saktësimin e pronave në fshatin Velçanin si administrativ e Gorë, projektvendimi për miratimin e përditësimit të pjesshëm të listës së inventarit të pronave të transferuara me vendim të këshillit të ministrave, numër pesëqind e njëzetë e katër, datë tre dhjetë i gjashti dy mijë e dhjetë, për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Gorës, qarkut Korçë. Të mbledhjes së bashkisë të këshillit të bashkisë Marliq, që do të zhvillohet në datë një i teti dy mijë e njëzet e pesë, të nderuar anëtarë të komisionit dhe të këshillit bashkiak. Ne, banorët e vitit një mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e një, në fshatin Vëlçan, njësi administrative Gorë, kemi marrë vesh nga rendi i ditës, se është shpallur në Këshillin Bashkiak Maliq, që do të ketë një mbledhje këshilli në datën një gusht dy mijë e njëzet e pesë, dhe që komisioni përkatës në pikën gjashtë të rendit të ditës.Pra, komisioni i financës do të ketë mbledhje në datë tridhjetë e një korrik.Në këtë mbledhje, sipas rendit të ditës, është parashikuar që pika gjashtë të jetë, për çështjen, projektvendim për miratimin e përditësimit të pronave, meqënëse kjo pikë parashikohet si kompetencë e Këshillit Bashkiak në ligjin 139, dy mijë e pesëmbëdhjetë, nenin pesëdhjetë e katër e si dhe nenin gjashtëmbëdhjetë një dhe nenin tetëmbëdhjetë një të po këtij ligji, si dhe në rregulloren përkatëse të organizimit dhe funksionimit të Këshillit Bashkiak, në rregulloren e Këshillit Bashkiak për marrëdhëniet e Këshillit Bashkia me Publikun dhe Median në nenin nëntëmbëdhjetë, mekanizmat e institucionet e ngritura nga Këshilli për Pjesëmarrjen e Publikut, si dhe në nenin 20, pjesëmarrja e strukturave komunitare në Kartën Europiane të Vetëqeverisjes Vendore në protokollin shtesë, që flet për të drejtën e pjesëmarrjes së publikut në çështje që, trajtohen autoritetet vendore, cec numër dyqind e shtatë në ligjin, njëqind e dyzet e gjashtë dy mijë e katërmbëdhjetë për njoftimin dhe konsultimin publik e shumë akte të tjera ligjore nënligjore kërkoj më me ngulmtë respektohet e drejta jonë për t'u konsultuar në të shkuarën e largët dhe të afërt ka patur plot gabime të qëllimshme e të paqëllimshme.Nëse kjo është një përmbledhje, kaq është me respect banorët e fshatit të veçantë të njësisë administrative Gorë dhe banorë janë dhjetë banorë me emër mbiemër, të cilët na shprehin këtë kërkesë. Duke qënë se ishte kërkesë e banorëve, ndjeva të nevojshme që ta ia përcillja këshillit.

Kryetari i Bashkisë z.Gëzim Topçiu: Po, unë besoj, ne e diskutuam këtë dhe le të ndodhin një procedurë që të takohen edhe për t'u qartësuar me njëri-tjetrin, nuk e di a është e domosdoshme kjo për pjesën e Pirgut, se aty s'kemi ankesa dhe s'dimë kë të takojmë, se s'e di për ke, për kë pasuri bëhen fjalë. Kështu që unë besoj që për pjesën që kanë ke, po të Velçanit le ta bëjmë një dëgjese publike me banorët, edhe le të jetë kjo dhe një farë mënyre, një ekspertizë nga drejtoria e pronave për t'u sqaruar dhe për t'i ndërmjetësuar, kurse përPirgun le ta kalojmë.

Faslli Zholi: Ne atë kemi në dorë atë kërkesën që është bërë në këshill.

Ornildi Demollari: Atëherë për pikën gjashtë, normalisht, ne e pranuam në rendin e ditës dhe duhet ta kalojmë në votim.

Kush është dakord me pikën gjashtë? Po pra, dorëzojmë për të rrëzuar projekt vendimin.

Ornildi Demollari: Po pra, dorëzojmë për të rrëzuar projekt vendimin. Atëherë jemi kundër për momentin me pikën gjashtë dhe shpresojmë që të realizojmë dëgjesën dhe pastaj në një mbledhje jashtë radhit të presim edhe një muaj ata që do t'i marrin kështu që.

Kush është dakord ? 2 vota pro
Kundër? 17 vota.
Abstenim? Nuk ka.Kështu që pika gjashtë do të trajtohet në një mbledhje tjetër, pasi të kemi zhvilluar një takim me banorët. Shumë faleminderit.

Ornildi Demollari:Kalojmë tek pika shtatë e rendit të ditës, projekt vendim për miratimin e transferimit në pronësi të Bashkisë Maliq, të pasurive me numër treqind e tridhjetë e katër dhe treqind e tridhjetë e gjashtë, zona kadastrale dy mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e pesë, fshati Pirg dhe për ditësimin e pjesshëm të disa pronave në listën e inventarit të pronave transferuara me vendim të Këshillit të Ministrave, numër tetëqind e njëzet e gjashtë, datë njëzet e një njëmbëdhjetë i dy mijë e dymbëdhjetë për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim komunës pirg të qarkut të Korçë Pra, është e njëjta pikë, por për fshatin Pirg ka ndonjë gjë? E kalojmë votim atëherë?

Kush është dakord ? 19 vota pro
Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Miratohet. Me 19 vota pro. Faleminderit. Pra, dua ta theksoj edhe një herë, nuk jemi në rastin e tjetërsimit të pronës që këshilli të jetë i detyruar me ligj dhe me rregullore që të dëgjojë banorët .Për këtë arsye, pikën shtatë, ndryshe nga pika gjashtë, e trajtuam dhe e miratuam në këshillin e bashkisë. Faleminderit.

Ornildi Demollari: Kalojmë tek pika tetë e rendit të ditës, P-V "Për miratimin e planit lokal të manaxhimit të integruar të mbetjeve të ngurta urbane të Bashkisë Maliq 2025-2035";

Petrit Kupe: Nildi këtu është bërë dëgjesa.

Ornildi Demollari: Këtu që u bë një, u bë një dëgjesë, ku ishin, ishin një pjesë e mirë e aktorëve dhe faktorëve të të paktën të kësaj çështje, kryetar, do të shtosh gjë këtu?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Dy fjalë, kjo është edhe detyrim ligjor, po në këtë periudhë që po e miratojmë, ka të bëjë edhe me performancën e vetë bashkisë. Qeveria, Ministria e Pushtetit Vendor, ka miratuar një vendimarrje, që ka të bëjë me performancën që bashkitë mund të përfitojnë nga fondet e buxhetit të shtetit për performancë të mirë.Një nga pikat është edhe programi, është edhe plani vendor i mbetjeve, plani lokal i menaxhimit të integruar të mbetjeve të ngurta. Janë disa pika të cilat ne jemi duke i zhvilluar, një ka të bëjë me miratimin e planit për arsimin parauniversitar, një ka të bëjë me planin social të veprimit të bashkisë tonë, i cili është miratuar një vit më pare, por ne do ta ripunojmë për ta përfituar edhe këtë në programet përkatëse që ka hapur Ministria dhe ky është programi i tretë, është me pikë. Është një program shumë i rëndësishëm.Ne paralelisht po miratojmë disa vende që kanë të bëjnë me depozitimin e mbetjeve të ngurta, të cilat drejtoria e pronave i ka bërë gati dhe i ka çuar për vendimarrjen në këshillën e bashkisë. Kështu që jemi në një linjë positive, që në një farë mënyre mbron mjedisin, përfitojmë nga fondet e buxhetit të shtetit dhe hyjmë në rrugën ligjore të asaj çfarë kemi detyrim si institucion.

Ornildi Demollari:Ka ndonjë pyetje tjetër për pikën tetë për planin e menaxhimit të mbetjeve?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Plani për të qënë i sinqertë nuk është kaq i vogël, plani është shumë më i madh. Nuk e di sa ia kanë sa është ekstrakti që ka kanë anëtarët e këshillit, por jemi munduar të marrim pjesën më të rëndësishme është më voluminoz, ka shumë kush do ta njohë, ai do jetë i shpallur në faqen e bashkisë. Kështu që këshilltarët, në qoftë se ka ndonjë pyetje, ne jemi të hapur për ta për t'i dëgjuar.

Ornildi Demollari:Kemi gjë, kishe gjë, mëson po, atëherë është.

Yllson Ibrahimllari: Edhe për konsultimin, edhe për projektvendimin në thelb, është një gjë shumë sensibilizuese që ju e keni bërë, do doja të diskutoja përsa i përket pjesës së konsultimeve publike që bën dhe dëgjeseve, që të kishte më shumë të gjendeshin mekanizmet, që të kishte pak më shumë pjesëmarrje dhe grupe interesi.

Ornildi Demollari:Të gjitha të duan.

Yllson Ibrahimllari: Jo, nuk po më fal, nuk thashë që kishim ndonjë tendencë për mos i marrë, sepse ne i kemi thirrur dhe këtu për dëmet në frutikulturë dhe s'ka ardhur asnjëri nga ata që ishin dëmtuar pemët.E pastaj thonë që kryetari nuk na jep lek kur. na dëmtohen, edhe se ç'ti bëjë

kryetari, se e di unë tani.Kryetari shumë shumë, një shkresë që vjen dymbëdhjetë maj, mund të na i sjellim më përpara. Faleminderit.

Ornildi Demollari:E kalojmë votimin? ju lutem.

Kush është dakord ? 19 vota pro
Kundër? Nuk ka.
Abstenim, nuk ka.
Miratohet. Me 19 vota pro. Faleminderit.Miratohet pika tetë e rendit të ditës. Kalojmë tek pika nëntë e rendit të ditës, që është projektvendim për dhënien e titujve të nderit. Komisioni për dhënien e titujve të nderit, mbledhur në datë njëzet e pesë, i gjashti dy mijë e njëzet e pesë, vendosi t'i propozojë për miratim këshillit të bashkisë dhënien e titujve të nderit.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Meqënëse kam qenë vetë në mbledhjen e komisionit, aty ka patur shumë debat edhe atë çfarë me të drejtë ka kërkuar komisioni, unë po tjetër dhe anëtarët e këshillit ka qenë një ristrukturim i rregullores për dhënien e titujve, për plotësimin e dokumentacionit, për në të përgjithshmen, që të jemi ta kemi më të precizuar të gjitha pikat, të cilat kujt i jepet një titull nderi, çfarë duhet të plotësojë, çfarë duhet të ketë, që mos kemi dhe ne të paktën problematika që një e miratojmë, tjetrën s'e miratojmë, por le të jenë dokumentacionet, le të jenë ato çfarë ata përmbushin për efekt të dhënies së titujve dhe llojit të titujve. E desha ta thosha këtë dhe i takon Drejtorisë së Kulturës, agjensisë përkatëse për një sektor të kulturës dhe trashëgimisë kulturore që të marrin eksperienca dhe nga bashki të tjera, apo të sjellin këtu elemente dhe vërejtje që vetë anëtarët e komisionit apo dhe këshilli mund të bëjnë, për të patur një rregullore sa më sa më të saktë, edhe që të mos lërë ekuivoke gjatë miratimit të saj.

Pranvera Begolli: Kryetar, meqënëse jemi te kjo pikë, kisha diçka, aktualisht e di që profesor Gjergji Merlikës i është miratuar një titull, i ka erdhur dhe ajo. Kur mendojmë t'ia japim, kur të krijojmë ceremoninë apo pas vdekjes? pastaj.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Po ça lidhje ka kjo me projektvendimin? Kjo mund të ishte në të ndryshme.

Ornildi Demollari:Lola, të lutem Lola.

Floreta Zaçe: Komisioni për dhënien e titujve të nderit, mbledhur datë 25 gjashtëdhjetë e dy mijë e njëzet e pesë, vendosi të propozojë në miratim të Këshillit Bashkiak dhëniet e titujve të nderit. Krenaria e bashkisë, Zotit Nexhip Bashllari, Vebi Skënderi dhe Ali Refatllarit.Gjithashtu mirënjohje e bashkisë, për zotërinjtë Ymer Nurka dhe Petrit Braçe. Midis të tjerave në komision u shpreh dhe u doli, ashtu si tha edhe kryetari, debate dhe probleme që të zgjidhen nga më mirë.U shtoj që të shikohet edhe një rregullorja. për dhëniet e titujve nga juristët apo nga bashkitë e tjera dhe të vazhdohet puna, sepse kemi pasur edhe debate nga zotërinjtë që nuk është

bërë kjo punë, nuk është bërë ajo edhe ndoshta qëndron, dhe kjo po duhet me rregullorja, ne vendosëm për këtë radhët këta persona, të marrin këto tituj që ju meritojnë. Faleminderit.

Ornildi Demollari:Po, yllson.

Yllson Ibrahimllari:Është një iniciativë shumë e mirë dhe unë do të doja që ne si këshillë të marrim të ngremë një grup, ndoshta duke qenë nëse e quajnë të nevojshme drejtoria e trashëgimisë kulturore dhe që të ketë edhe një pjesëmarrje të këshilltarëve në atë rregullore që do hartojmë, bëjmë një projekt rregullor, pastaj i takon këshillit veten, miraton ose se miraton Këtu debatet nuk kanë ardhur për këtë gjë, debatet janë ndryshe. Kryetari ka krijuar një komision dhe është para arsyeshme mbas një vendimi të Këshillit Bashkiak që e kemi diskutuar. Ka një grup konsultativ për tituj që i takon kryetarit për të dhënë. Këshilli bashkiak ka një komision të titujve që ka këtu dhe s'ka asgjë dhe ne nuk po, nuk po krijojmë struktura paralele.A ka mundësi ta dimë çfarë do t'i japim kujt dhe përse? Ta marrim atë regjistrin që regjistrohen të gjithë këto titujt. Besoj Gerti i ka aty. Në gjithë listën e kohës tonë, le të verifikojmë as të anatemojmë, as të përgojojmë ata që i kanë marrë titujt. T'i gëzojnë mire, tani del doktori Yllson Iraimllari, qytetar nderi i Bashkisë Maliq, edhe na del profesor Ali Refatllari "Krenaria e qytetit", megjithatë, unë nuk po them atë mund ta çmoj kushdo, secili e kanë veten e vet e tjera, unë shikoj te ai komisioni i kryetarit, me cilin ndaj. Ne bashkë do ndajmë shumë gjëra, ai të ketë një të ardhme të mirë, të shëndetshme, të jetë xheneros, siç është këtu edhe në të ardhmen e vet, po besoj që ne do jemi ky këshill që këta në futboll i thonë se meqë është edhe natyrë sportive, kryetari i vari këpucët në gozhdë, domethënë në kuptimin ligjor të mandateve.Ti të jesh tërë jetën, kryetar bashkie, po ky këshill, me sa di unë, ligjërisht e mbyll dhe këtë pjesë, kështu që ne do kemi harmoni dhe besoj do kemi respekt në të gjithë rrugën e bulevardit të Maliqit. Që të rrimë pak, se është diskutuar dhe pak kjo çështje që jo, Yllsoni po na kërkon,Yllsoni ka kërkuar këtu në këshillë bashkiak, CV e personaliteteve që ka si komision ndihmës këshillimor kryetari, unë s'kam asgjë personale, as me njërin as me tjetrin. Po kam parë ca njerëz, personalitete aty, mësuese të tjera, që kanë datëlindjen nëntëdhjetë, nëntëdhjetë e një, dhe pastaj kam parë në shumicë organizata e veteranëve të bashkuar, organizata këtej, duke pasur dy dëshmorë te familja.Thashë, pse s'po marrin dhe mua. Kisha nja dy para te lufta e dytë, pastaj m'i bën dhe ca më mbrapa, kështu që i plotësoja dyja kriteret. Unë besoj që kur marrim përsipër të themi këtë, është një peshë shumë e madhe e jona. E kam biseduar me kryetarin, a ka mundësi të ketë? Meqë kemi palafitet, meqë jemi një zonë me histori të gjatë, ketë edhe zotin Ceka e personalitete të tjera. Më mirë t'i marrim një vendim e t'i paguajmë me honorar ata dhe ta bëjmë vjetor atë mbledhjen e këshillit. Se sa ta shih të vijnë ca me pantallona të shkurtra e të më thonë që Ali Fatllari është kardiolog, jo mo zotëri, keni atë zonjën aty të nderuar personalitet që mungon sot, që është mjekë, Ali Fatllari s'ka qenë asnjëherë kardiolog, është kardiokirurg. Megjithatë, nuk është këtu, nuk po merrem me të vogla.Bashkia e ka, komisioni e ka për ta nderuar.Unë them edhe një gjë tjetër, para shumë vitesh,në atë kohë nuk kishim as debate njëri me tjetrin.Ndjesë pas t'i them zotit Nishani, ndihmojnë pak ata kapedanët, e shkojnë në Gorë, e priti me ceremoni, vuri dhe shiritin kryetari.Vrisja mendjen tashi më mbrapa, mos është Pashua pengesë, meqë ka shumë veteran këtu.Pashua na qenka miratuar se e paska sjellë Koçiu, te kaprdenët e Gorës na ra

dhe Pashua. mos ka bërë ndonjë gabim baba kalenderi, po na ka mundur të tërëve me referendum, bashkë me kryetarin vëmë katër mijë pesë mijë veta, mblidhen atë ditë. Nuk e di pse nuk i jepet Dervishi Iljazi në Tomorr, ku vete kryetari njëzet e tre, bashkë me mua është nderi i kombit. Dervish Luzha, nderi kombit në Tropojë. Pse nuk na u dashka ka ky baba kalenderi për t'u nderuar? Dhe këtu jemi përballë një gjë, ju lutem, shumë miqësisht dhe shumë qetësisht. Po fyeni firmën e katërmbëdhjetë këshilltarëve që kanë firmosur në datën njëzet e tetë, i treti, dy mijë e njëzet e katër. Jemi. Sinemaja vjet, kinemaja sivjet, grupi i koncertit erdhi e tjera. Kjo tani më vjen keq, ka vend për reflektim.Hajt të hyjmë asaj rregullore, siç është. Hajt të miratojmë, hajt të dalim ta dimë edhe ta themi këtë gjë. Nuk po kërkoj as gjyshin tim, as tjerën. Nuk e di, një herë të vetme kam ngrënë një drekë me ndjesë të paste me Arish Pipën.Po diskutojmë edhe një gjë, e shoh në çdo ceremoni, vjen në gojë me mikun tim, me xhaxhain tim Fidai Çaushllarin dhe kurorën, po kalo dhe një herë këtej nga grypa e poçestës, se të duam të tërë, o kryetar. Ka dhe një lapidar aty për ata që kanë tharë kënetën, e di, nuk e diskutoj, po ti je më mëndjehapuri nga ne, mo ne jemi refraktarë. dhe bile, bashkë përpara se ta mbarosh mandatin, do vëmë edhe pllakën te sabotimi.Po do bëhem një studim për ta bërë këtë gjë.Thotë Vera do më rrahi, po fola kështu prapë e presim.Ne s'ka gjë për debat jemi këtu. Faleminderit.

Orinlidi Demollari: Festim, të lutem.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Në asnjë nga emrat që ka diskutuar komisioni atë ditë, nuk u tha që nuk i takon. Se dua të shkoj tek emri, tek baba kalanderi, ku ne të shkojmë të gjithë, i vetmi diskutim që u bë është që të paktën për çdo lloj emri që ne japim, duhet të ketë një document dhe sipas materialit që ishte, sipas propozimit, po meqë e zura këtë, po dhe për emra të tjerë, duhet të vendosim disa piketa, mund të jetë që për njerëz të Zotit apo njerëz që janë të këtillë. Mund të jetë nga një komunitet, nga ku unë nuk di si ta shpjegoj, por diçka duhet të ketë në rregullore.

Yllson Ibrahimllari:Këto të përbashkët, pse e bëre qytetar nderit të Bashkisë Maliq? Baba Sadikun e bëra, e ke këtu.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:E bëra, e bëtë ju, e bëni këshillin, pasi kishte disa dokumenta, të cilat i pasqyruan në mbledhje.

Yllson Ibrahimllari: Nuk diskutojmë këtë gjë, mo.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Ky këshillë, apo dhe këshilla të mëparshme, mund të kenë marrë vendimarrje dhe jo shumë të sakta dhe jo shumë të drejta. Janë munduar të vlerësojnë tituj, emra, nderi, edhe mund të ketë edhe aty momente diskutimi, i takon si takon, jo ky titull, pse ky titull? Ne s'kemi pse t'i paragjykojmë.A kemi mundësi të nderojmë dhe të respektojmë sa më shumë emra dhe figura që kanë kontribuar për zonën tonë, pasi nuk i kemi kaq me shumicë dhe unë s'jam kundërshtim për këtë punë, por disa modalitete që duhet t'i vendosim kulturës, që t'i sjell të përgatitura dhe s'kam asnjë kundërshtim që aty hajde të bëhemi pjesë të gjithë, edhe

anëtarë të këshillit, edhe historianë, edhe kujt unë arkeologë, edhe kujt unë profesorë, që të kemi një dokumentacion, një rregullore sa më të saktë, që ajo të flasë vetë, jo të vendosim ne pas saj. Ky s'më pëlqen, se e ka sjellë Fevriu ky po e kaloi, se e ka sjellë tjetri nuk duhet, ne duhet ta shikojmë vetëm në zbatim të asaj rregullore.

Orinlidi Demollari: Festim, të lutem, faleminderit kryetar.

Petrit Kupe: Për mendimin tim, kjo pikë është zgjatur shumë derisa erdhi derisa erdhi deri tani edhe mendoj, ka një arsye të që është logjike që mungon dhe rregullorja e funksionimit të edhe të këtij komisioni apo dhe përbërjes të këtij komisioni.Mbasi gjatë këtyre dy vjetëve, për mendimin tim, pak figura janë vlerësuar. Duhet të jemi të sinqertë, do të jemi të ndërgjegjshëm. Ka shumë figura të tjera, shumë e shumë të tjera kudo në fushën e biznesit, në fushën e arsimit, në fushën e histories, e arkeologjisë dhe për mendimin tim, ky komision nuk ka funksionuar në krahasim me propozimet apo me vlerësimet e figurave. Kështu që në rregullorën e re, mendoj unë, duhet të përcaktohet, përveç përbërjes, edhe një farë afati se si do të mblidhet ky komision. Jo kur e kërkon Vilsoni me ngulm një vit të tërë e mblidhet pas dy vjetësh ose kur e kërkoj unë. Po të ketë një afat, ky komision mblidhet një herë gjashtë muaj, pse s'është e thënë që në çdo muaj do të bëjmë vlerësim të figurave, por duke grumbulluar, duke plotësuar gjithë CV, gjithë materialin, paraqet propozime në këshillë, për vlerësimin e figurave sipas kontributeve, sipas kontributeve dhe vlerësimit, jo të gjithë të një standardi. Kështu që kjo rregullore dhe kjo punë e bërë nuk është bërë e mirë, ndërsa kjo rregullore mendoj se duhet të faleminderit t'i rregulloj.

Përgjegjës i Sektorit Kulturë, Arte, Turizëm; z.Festim Tomorri: Faleminderit, kryetar, unë në vazhdimësi të fjalës do të thosha që ka një iniciativë konkrete për rregulloret. Ka sjellë kryetari pranë komisionit një rregullore sipas asaj që ai e ka menduar. Ka dhe një iniciativë të një grupi të komisionit të dhënies së titujve, që kemi përgatitur një rregullore, të cilat kemi dy drafte rregulloresh. Unë do kërkoja nga këshilli, e kam kërkuar edhe herë të tjera, që këshilli vetë të krijojë një komision, ndoshta të përkohshëm, që të krijojë një një një rregullore, duke u dhe t'i bashkojmë të treja, e të zgjedhim më të mirë. Duke u nisur nga fjala para në rregulloren e re, në rregulloren e vjetër, në atë që ekziston sot, ne i kemi të gjitha këto që shprehu zoti Kupe. Janë të gjitha dhe afatet dhe koha kur duhet të mblidhet, dhe të gjitha janë po. Ka një ngërç tek mënyra e dhënies së titujve, sepse janë kaq afër njëra-tjetrës, sa s'mund të ndajë dot komisioni se si mund t'i japë një titull që të jetë qytetar nderi ose krenari e qytetit. Këto dy ose tre gjëra duhet ndarë, që të kenë një ndarje, një kufi të përcaktuar se kur jepen. Këto ngatërrohen me njëra-tjetrën, sepse janë afërsisht të njëjta dhe për këtë, dua ndihmën e ndoshta specialistave.

Orinlidi Demollari: Ju lutem, ai përcilleni sekretarit të këshillit ato dy drafte.Sekretarit ia u nda gjithë kolegëve, pastaj edhe të japim mendime dhe ta miratojmë.

Përgjegjës i Sektorit Kulturë, Arte, Turizëm; z.Festim Tomorri: Sa për pjesën e fundit, më fal. Ishte një gabim ajo e Zotit Refatllari, që është shkruar në kardiolog. Jo, ka rëndësi, sepse unë

Refatllarin e kam mik të familjes, ai mik të vjetër familjes, që që fëmijëri dhe është një gabim që ndoshta e kam bërë unë.

Yllson Ibrahimllari: Unë i kam thënë, duke qenë se estimi është miku juaj i familjes që ju ka lënë një vit e gjysmë për ta shtyrë si afat si sekretar komision.

Përgjegjës i Sektorit Kulturë, Arte, Turizëm; z.Festim Tomorri: Ke të drejtë, ke të drejtë, ndoshta, po aty, aty është, është një, një, një vendimarrje që e ka, e ka, është kolektive. Unë e kam çuar, po pastaj është edhe kjo.

Orinlidi Demollari: Ju lutem, ju lutem që mos merremi me këto lloj fisnikesh të tilla kështu. Ju lutem, tani mbaruan diskutimet.

Yllson Ibrahimllari: Jo, s'kemi mbaruar, po flasim për rregulloren, po ja pra po flas, okej dakord, atëherë është problem, rregullorja me dy draftet që vjen, vjen te komisioni i titujve që ka vetë këshilli bashkiak dhe kush prej anëtarëve të këshillit do të bashkëpunojë me komisionin e titujve që ka këshilli, ja ku është zotëria, pesë vetat e tjera ata diskutojnë paraprakisht në komision dhe komisioni i ligjeve dimë, por duhet të kemi parasysh dy gjëra, ju lutem. Dy mijë e njëzet e treshin dhe dy mijë e njëzet e katrën kanë ndryshuar ligji i titujve të nderit dhe i dekoratave që i ka firmosur Zoti Begaj dhe Zonja Nikolla.Që t'i kemi dhe dy ligjet e fundit.

Orinlidi Demollari: Kalojmë në votim, atëherë ju lutem, kush është dakord me pesë emrat dhe vlerësimet?

Kush është dakord ? 19 vota pro
Kundër? Nuk ka.
Abstenim, nuk ka.
Miratohet. Me 19 vota pro. Faleminderit.T'i gëzojnë zotërinjtë titujt e nderit.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Në lidhje me një që s'ia kemi dhënë titullin, ndoshta duhet t'i organizojmë të gjithë. Ne kemi disa tituj të pa dhënë ende, nuk është faji jonë, ndonjëherë se nuk përputhemi për t'i gjetur personat në fjalë për të realizuar festimin, besoj duhet të merret.Unë dje kam patur takim një kafe me ish futbollistin e kombëtares ne e kishim bërë gati, ai nuk na erdhi. Tani, si duket, është gati.

Yllson Ibrahimllari:Është një gocë që është kampione në Greqi në peshëngritje.Pogradeci ia ka dhënë atij Muçit të Tiranës që luan me atë. A mund të flas më të sjellë krahasimin? Tani, Ernest Muçi që luan në Turqi, lojtari i kombëtares, është krenaria e Bashkisë Pogradecit Kjo goca që është nga Lozhani Xhengo, pavarësisht se mban pashaportë greke, ti jepe titulli, sepse nderon rininë në sport, ku e ka.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: o mund ta propozoni bashkë me një dokumentacion bashkëngjitur dhe hajt ta shikojmë.

Orinlidi Demollari: Kalojmë tek pika tjetër e rendit ditës, që ram dakord për ta shtuar në këtë renditë që është projektvendim për miratimin në parim të hapjes së një rruge rurale në ndihmë të komunitetitnë ngastrën pyjore numër tetëdhjetë e dy, zona kadastrale tre mijë e dyqind e shtatëdhjetë e nëntë, fshati Selc, njësi administrative Gorë.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Është një rrugë rreth njëqind apo njëqind e pesëdhjetë metra gjatësi, njëqind e shtatëdhjetë. E kanë kërkuar ta hapin ndonjëherë s'merren vesh me njëri-tjetrin, por ne duhet të jemi korrekt në konceptin tonë që ne nuk bëjmë dot asnjë veprim pa një vendimarrje të Këshillit të Bashkisë, se ndërhyjmë në një pronë.Kështu që duhet një vendimarrje që kjo t'u shërbejë banorëve.

Yllson Ibrahimllari: Pjesa hartografike duhet të ishte më e saktësuar dhe me një vizim të madh.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Dhe në zbardhje të vendimit të jetë ashtu siç thua ti.

Orinlidi Demollari:Kërkesa vjen, kërkesa vjen nga pesëmbëdhjetë banorë të atij fshati, kështu që. E kalojmë votimin, atëherë kush është dakord?

Kush është dakord ? 19 vota pro
Kundër? Nuk ka.
Abstenim, nuk ka.
Miratohet. Me 19 vota pro. Faleminderit.Tani shkojmë tek materiali tjetër që shtuam në fillim të mbledhjes, që është informacion. Lenda relacion mbi situatën e dëmeve të shkaktuara nga kulturat bujqësore dhe bora, bora dhe ngricat e muajit prill, është një material që është për bujqësinë kryetar.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Po unë do të shpjegoj që ne shumë herë jemi angazhuar në teme që kemi pasur në bujqësiedhe të paktën sa kam unë nuk është se janë trajtuar ndonjëherë financiarisht me për dëmet që janë shkaktuar nga fatkeqësi të ndryshme natyrore, kemi patur breshër, kemi patur zjarr,zjarri është parë në koncept tjetër, po në banesa, ndoshta në bazë ushqimore, aktet ligjore nuk e përmbushin.Në vendimarrjet apo në aktet ligjore në fuqi, përcaktohet që kur ka dëme të tilla dhe dëmet janë në nivele që bashkia mund ta mbulojë me fondin e vet për efekt të mbulimit të emergjencave civile, po fondet në koncept në ato fonde në sasinë e lekëve tek ne shkojnë, po themi maksimalisht shkojnë rreth dhjetë milionë lekë të reja edhe për demet që flasim, që shifrat janë të konsiderueshme në asnjë vit nuk mund të mbulohen me të ardhurat tona apo me fondet e dedikuara për emergjencat civile, si nga buxheti i shtetit, si nga të ardhurat tona. të cilat hyjnë në këtë zë, kështu që në mbas këtij rasti, ligjvendësi ka parashikuar që ne i drejtohemi prefektit të qarkut i drejtohemi Agjensisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, që ata e shikojnë si rast të veçantë për shpalljen esituatës e fatkeqësisë natyrore dhe vetëm

në ato raste shteti është i detyruar të paguhet.Edhe për këtë rast, nuk është marrë në konsideratë.Kështu që jemi para një fakti të tillë, të cilët nuk përfitojnë. Ajo çfarë ne po bëjmë dhe Ministria e Bujqësisë tashmë e ka drejt finalizimit është një projektvendim me financim edhe me ekspertë turq, prefekt të sigurimit të prodhimeve bujqësore, ku edhe shteti do të jetë palë nëpërmjet shoqërive të sigurimit, që ai i cili ka ngastra apo volume të mëdha në bujqësi apo në blegtori bën një siguri tek shoqëritë e sigurimit, që sot ndodh rrallë, ndodh në element të veçantë kur shoqëritë e sigurimit kanë garanci që nuk dëmtohen gjithmonë, nuk dalin me humbje, por në momentin që shteti do të bëhet palë e do të mbulojë po themi tridhjetë, dyzet apo pesëdhjetë përqind të vlerës së demit, atëherë edhe shoqëritë e sigurimit me ligj tashmë mund të jetë zgjidhja që unë e mendoj do të jetë e shpejtë dhe do të sigurojë të paktën do të rritë numrin e të interesuarve për të siguruar produktet apo prodhimet bujqësore dhe blegtorale. Elementë të veçantë pastaj për shifra, ndoshta zyra e bujqësisë, drejtoria e pronave mund t'i japë një informacion më shumë, pavarësi të pyetjeve që mund të kenë këshilltarët.

Petrit Kupe: Duke pare këtë proceverabl, megjithëse pak me vonesë në krahasim me zonën. Unë mendoj se më duket se mendimi i tij ndoshta jam i gabuar, sikur është bërë që këtej nga zyra. Sepse në territorin që unë të paktën banoj, ose në njësinë që jam si këshilltar, më duket që nuk kishte asnjë kokërr kumbulle, asnjë kokërr qershie që mund të dilte në treg. Dhe këtu thotë kjo. Nga tre pikë tetëdhjetë e dy kumbulla hektar janë dëmtuar një pikë nëntë, nga njëzet e katër hektar që e shih, janë dëmtuar dhjetë.Ku e di unë, qofsha unë i gabuar, ndaj më duket sikur është bërë që këtej në më shumë, ose është bërë e nxituar për të tjerët. A ndoshta për mos paraqitur shkallën e vërtetë të demit, po këtu nuk ka asgjë. Sepse njerëzit na qeshin kur shikojmë që s'ka ka qershi të padëmtuara dhe kumbulla, këtë mendoj, qershi do më parë në shtëpi çfarë? Hiç fare, as kumbulla.

Orinlidi Demollari: Beni kishe gjë për këtë po.

Përgjegjësi Sektorit të Bujëqsisë: z.Arben Dullillari: Nisur nga problematika e dëborës dhe e ngricave të fillimit të muajit prill. Vërtetë që një situatë problematike në pemëtari, sepse ato ngrica dhe dëbora që zgjati me ditë tëra ngrica me shoqëra dhe me brymë me temperatura të ulta, na futi një farë frike.Ndaj, edhe ne në atë periudhë ju kërkuam që ky vlerësim i situatës të bëhej në dhjetë ditëshin e fundit të muajit maj dhe konkretisht u bë.Realisht, nga ajo që pamë në terren, qoftë në lulëzimin e pemëtarisë edhe në lidhjen e kokrrave rezultoi që në disa zona, si për shembull në zonën e Pirgut, të kishim zero probleme në drejtim të dëmtimit në mollë. Gjithashtu, në kumbull, pavarësisht se nuk kemi shumë sipërfaqe në blloqe, edhe në këtë nuk ka ngarkesë me prodhim, qershia që me dëmtuar, sidomos varietetet e hershme, varietetet e vonëshme patën prodhim, qoftë në Poceset ku kemi por ne kemi sjellë edhe këto shifra këtu, që ato që kemi të kadastruara, jo ato që kanë mbjellë. faktikisht, kemi edhe shumë sipërfaqe të zaptuara, me atë problematikën që fillojnë sqarimet në fillim për drejtim të pronave, kemi sipërfaqe të pa.dhëna me qera që janë zaptuar, që ndaj kërkojmë edhe atë azhonimin edhe pajisjen me çertifikata të këtyre pronave.Realisht, sipërfaqet në mollë kemi gjashtëqind e pesëdhjetë hektar dhe dëmtim kemi rreth dymbëdhjetë hektar, por ato që do të theksoj unë, që më problematike ishte situata në

pjesën e Rrëmbecit, ku qoftë ngrica, qoftë edhe rrymat ajrore, ku ishin më të fuqishme dhe përplaseshin me njëra-tjetrën, pati dëmtime, aty kemi përgjithësisht këto dëmtime. Ndërsa në kumbull kemi rreth dymbëdhjetë pikë shtatë hektarë dëmtime. Thashë që mbjellje ka më shumë, po të shikoj sipërfaqen e Poçestës edhe të Klotës në kodrat janë më shumë edhe diku tjetër në Podgorije.Gjithashtu, në qershi kemi rreth njëzet e gjashtë pikë tetë hektar Besoj se këto janë në blloqe.Nisur pemët e veçanta, pastaj është gjë tjetër që mund të kenë në fund parcelave ato. Neve, bazuar në urdhrin e ngritur nga kryetari i bashkisë, i kemi shkelur çdo fshat dhe çdo bllok të mbjellë me pemë frutore dhe kemi nxjerrë këto shifra që kemi raportuar këtu, që u kemi sjellë juve, dhe nuk është e vërtetë ajo që i kemi bërë nga zyra, sepse ne e njohim situatën mirë, i kemi shkelur. Prodhim ka patur në qershi diçka në varietetet e vona, që çelin vonë edhe ndryshimet klimatike në një farë mënyre bëjnë punën e vet dhe më shumë po goditet bujqësia sigurisht, është nën ndikimin e kushteve atmosferike. Ndaj dhe mbeten probleme të tjera që diskutohen me fermerët. Mbjellja e varieteteve më të vonshme, sepse ato temperatura dhe ngrohtësinë që patëm gjatë shkurtit dhe marsit, nuk i kemi patur në maj ose në fund të Prillit. Kështu që realiteti ky është ka fermerë që janë goditur më shumë, mbase aty po ka ndonjë hapësirë për t'i ndihmuar është gjë tjetër pastaj.

Orinlidi Demollari: Po faleminderit, ka ndonjë pyetje?

Yllson Ibrahimllari: Atëherë, ne kemi iniciuar një mbledhje jashtë radhës dhe jemi dakordësuar me kryetarin për të diskutuar këtë gjë. Rregullorja na i lejonte, kemi thënë që do t'i drejtohemi institucioneve. Bashkia i është drejtuar, thamë mund të kishte dhe një drejtim nga këshilli, nuk ramë dakord në atë pjesë. Problematika që diskutojmë është është e tillë, duket që është bërë këqyrja e parë e dëmit, vala e parë.Thamë pastaj të shikojmë sythi, sa do t'i rezistojë. Nuk kemi një pasqyrë të rivlerësimit të dëmit. Pra, pasqyrën e parë që kemi pasur në mbledhjen e parë të këshillit, atë kemi në këtë materia Ddhe ndërkohë, tek rreshtat e fundit të këtij informacioni që na vjen, kemi dhe një përgjigje të Agjensisë së Emergjencave Civile, e cila nuk e ka pranuar sugjerimin që kapacitetet ekonomike ishin më të mëdha për shpalljen e gjendjes së Fatkeqësisë natyrore, ne nuk e kemi shkresën që ka sjellë agjensia, që të diskutojmë ça kriterësh, pse nuk është plotësuar, si është plotësuar.Ajo mund t'i dhë një shkresë e thjeshtë, nuk duam ta bëjmë. E ndodhemi këtu, në mbledhjet e vitit të kaluar kemi diskutuar bashkarisht, kanë ardhur edhe siguracione një kompani që interesohesh, e diskutoj Luli. ka diskutuar unë Andonaqi. Në cilën si të jetë mundësia? Ka ndonjë siguracion tek tuk, por kjo është e përvitshme. Neve, si këshillë, tani bashkë me gushtin na ikën dhe vapa, duhet t'iu themi atyre njerëzve, hapni çadrat kur ndodhin këto gjëra, se ne s'ju mbrojmë dot, lekë qeverisë i marrim, gjëra s'ju bëjmë dot.Këtu vlen për të diskutuar pastaj puna tjetër, edhe të bashkërendimit, kryesia po e bën mirë punën e vet, por nuk ka nevojë që të zhvillojë debate të tilla, për shembull, për këtë informacion ishte një gjë që, pse sillet informacioni, opozita ngriti pretendimi pse zien informacioni në kohë, unë besoj që të jemi një çik më të gjerë, më të hapur njëri me tjetrin, se është një gjë tashi sikur themi që ky është i paplotë, se s'ka ardhur ajo shkresa. Ne kemi detyrimin edhe për të parë, sepse njerëzit po vijnë aty jashtë, na kapin, na thonë, ç'u bë me ato dëmet, ç'u bë, dhe ne të jemi dhe të informuar. Nuk mundëm s'na përfilli njeri kaq forcë kemi. Faleminderit,

Orinlidi Demollari: Faleminderit. Kam një pyetje tjetër për këtë materialin informues.Mund të largohet, po mund të largohet. Ka ndonjë pyetje tjetër për këtë materialin? Jo, atëherë kalojmë Ky ishte material informues, nuk ka nevojë për votim. Kalojmë tekmaterialet e tjera që janë materiale informues. Bashkia Maliç është një material përmbledhës i të dhënave të pyetësorit të plotësuar nga Bashkia dhe Këshilli Bashkiaknë kuadër të barometrit për barazinë gjinore në nivel vendor dhe janë disa të dhëna statistikore që kanë dalë nga.matja, pjesëmarrja e grave dhe burrave në strukturën e bashkisë. Punonjës në bashki është 267 gra, 346 burra. Pozicione drejtuese janë dymbëdhjetë gra, dymbëdhjetë burra, barabar. Administratë, administratorë të njësive, një grua dhe gjashtë burra. Këshilli bashkiak, një zëvendës kryetare dhe dy. Kryetar dhe zëvendës kryetar, është një material që ju besoj e keni dhe s'ka nevojë që të ta lexojmë tani dhe të ndalemi tek kjo. Dhe një material i fundit është një kërkesë drejtuar Bashkisë Maliq, Këshillit Bashkiak, Njësisë Administrative Maliq, thotë Prefekturës Korçë, Drejtorisë. Rajonale të ujësjesit, deputetit të qarkut Korçë, lënda kërkesë urgjente për zgjidhjen e mungesës së ujit në lagjen Qesarat Maliq.Të nderuar përfaqësues të institucioneve, të nderuar këshilltarë, kryetar i këshillit dhe kryetar i bashkisë Maliq, zoti Gëzim Topçiu, ne banorë të lagjes Qesaratë të qytetit të Maliqit jemi detyruar të shprehim shqetësimin tonë të thellë dhe të përsëritur ndër vite në lidhje me mungesën e ujit të pijshëm që po përjetojmë prej më shumë se një muaji, aktualisht furnizimi me ujë bëhet vetëm një herë në ditë në oraret shtatë. me nëntë e tridhjetë të mëngjesit, duke qenë krejtësisht i pamjaftueshëm për nevojat jetësore të familjeve tona, kjo situatë e papranueshme në një vend që synon integrimin në Bashkimin Evropian dhe në një kohë kur standardet bazë të jetesës duhet të jenë të garantuara, na vendos përballë vështirësive serioze për mbijetesë, higjienë, ushqim dhe edukim.Është e pafalshme që në vitin 2025 furnizimi me ujë të jetë ende një problem i pazgjidhur, ndërkohë që kryetari i bashkisë mban këtë post prej disa vitesh pa sjellë ndryshime thelbësore në jetën tonë të përditshme, kjo situatë ka qenë edhe kur banorët bënin pagesë prej njëqind lekë për frymë, furnizoheshin me të njëjtat orë në ditë për plot katër muaj, qershor, korrik, gusht, shtator, dhe vazhdon e njëjta situate, ndonëse janë vendosur macit dhe çmimi për metër kub është rritur me shumëfish ndër vite. Kërkojmë me urgjencë një verifikimin e menjëhershëm të gjendjes së rrjetit të ujësjellësit në lagjen Qesarat. Dy, zgjidhje të qëndrueshme për furnizimin normal dhe të pandërprerë me ujë të pijshëm. Tre një plan të qartë për të publikuar për përmirësimin e shërbimeve bazë në zonën tone. Nëse nuk merren këto masa në një kohë të arsyeshme, do të jemi detyruar të përshkallëzojmë shqetësimin tonë përmes peticioneve, mediave dhe strukturave të tjera vendimarrëse kombëtare dhe ndërkombëtare. Me respekt, disa banorë të lagjes janë rreth dhjetë-dymbëdhjetë banorë të asaj lagje.

Andonaq Risto: Nidi, më falni.

Orinlidi Demollari: Furnizimi me ujë i asaj lagje vazhdon me të njëjtin orar në mëngjes, një orë dhe një orë e pak në mbrëmje. Kjo është e njëjta situatë, po.

Andonaq Risto: Tashi duke parë situatën dhe meqë ka dërguar edhe kjo zonja, unë kam qenë dhe ne kishim probleme me ujin e pishin para një muaji dhe kemi dalë vetë në terren për tëqë e rregulluam dhe uji ka.Ujka, por ne unë dua të bëjmë me di kryetarin që punonjësit e ujësjellësit

janë të gjithë, të gjithë pa përjashtim, të papërgjegjshëm dhe nuk merren me asnjë lloj pune që atyre u takon. Unë e di që në çdo fshat ka lidhje të dyfishta, që të cilët ata i lejojnë dhe i vijnë, dhe ne arrijmë në këtë pikë që nuk mund të marrim ujë të pishën për disa arsye dhe dua ta vë në dijeni dhe i kam thënë dhe personalisht po ia them edhe këtu që duhet të merren masa urgjente me njerëz të saktë dhe jo me njerëz që nuk janë të aftë të punojnë, sepse vuan i gjithë populli, të gjithë njerëzit vuajnë sot për ujë, duke e ditur që uji ka. Dhe me matjet që kemi bërë, unë bëra matje në depon tonë dhe bëra me inxhinierat. Depoja tonë nxirrte rreth dyqind metra kub, gjashtë mijë metra kub në muaj, kur arkëtohen një mijë e treqind deri në një mijë e katërqind metra ku ku shkon uji, unë nuk e di dhe unë ia bëra pyetje, punonjësve, punonjësve, sepse s'e dimë gjëje ti. Ta gjej unë, duhet ta gjej unë, se mua më takon se unë punoj atje. Kaq ç'kisha pyetur, faleminderit,

Petrit Kupe: Po ja të them diçka, meqë kam punuar gjashtëmbëdhjetë vjet në atë sektor.Më duke gjykuar dhe jo me tendencë, por këtë vit thatsira ka qenë tej mase e zgjatur dhe për rastin në fjalë janë tronditur edhe burimet e Kolanecit. Është vit i veçantë që po bëhet edhe kufizimi i natës në qytetin Maliq. Megjithatë, kjo se e përjashton mundësinë e menaxhimit më të mirë.Qesarata sot nuk ka ujë, ose ka pak ujë, sepse shpërdorohet shumë ujë në rrethinat e Maliqit, të qytetit të Maliqit.Vera është pjesë e atyre rethinave dhe kjo e kemi kapur duke e vaditur. Për shaka. E kam fjalën që ka mundësi të menaxhohet dhe që Sarata të ketë edhe që Qesarata të ketë më shumë ujë. Qesarata ka patur ujë njëzet e katër orë, po që të katandisen dy orë, unë nuk e kuptoj. Më thonë që kanë bërë disa linja të tjera që kanë shmangur qesaratën nga furnizimi i mëparshëm, kanë bërë disa linja për sy mizit, nuk e di sa janë të vërteta. Por fakti që s'ka njeri nga ujësjellësi të vijë këtu, se aty është shkruar, nuk e di, s'ka drejtë bashkia ta thërrasë. Mendoj që ka mundësi që të përmirësohet situata.

Orinlidi Demollari: Kryetar, meqënëse jemi dhe unë jam banor i asaj lagje, desha të shtoja përveç shqetësimit të ujit, banorët kanë dhe një shqetësim për furnizimin me energji elektrike, sepse e gjithë lagja furnizohet me një linjë tjetër, me një fidër tjetër, që furnizohet qyteti dhe ndjen pak të veçuar ndodh që kur ka ndërprerje atje, qyteti ka furnizime energjie elektrike. Jo, s'ka pasur, po është një, është një shqetësim.Jo, nuk është i dobët, banorët kërkojnë që të fundit, se kemi qytetin. dhe na ndodh, na ndodh që jemi më të penalizuar nga ndërprerjet sesa qyteti, se jemi me një linjë rurale. E ndjeja detyrueshme ta thoja këtë, se është shqetësimi i banorëve.

Faslli Zholi: Unë duhet të shkoja këtu në ujit, pavarësisht një punë të mirë që është bërë nga bashkia, se shikojmë gjithë territorin Qesarata ka të drejtë, kur është një orë, është e pa pallogaritshme duhet të shikohet ajo në qoftë se është kështu e vërteta, por unë ajo duhet të theksoj një diçka.Faktikisht, ai djali përgjegjës përpiqet shumë. Është e vërtetë që unë e kam shkuar me të edhe diku për ujin e për disa gjerë. Është për të falenderuar ai djalë i ri, që është mbase ashtu përsa i përket punonjësve që ka ai, ia kam thënë dhe atje po e them edhe këtu, dal tek llafi i Naqes që duhet kërkuar, sepse po u shikoj Libonik ka lidhje të paligjshme dhe të vaditesh me lidhje të paligjshme dhe të rri që Qesarta pa ujë kjo nuk është e drejtë, kjo duhet shikuar mirë.Dhe së dyti, çfarë duhet të them në fshatin Libonik? Ndalohet ujit në orën dhjetë të

darkës fiks dhe hapet në orën shtatë. Unë ngrihem gjashtë e gjysmë, do shkoj në punë, nuk lahem dot. Duhet parë kjo, dhe këtë e them me kompetencë që ka lidhje të paligjshme, të cilat badijnë. Këtë ne duhet ta vëmë në hudut, dhe kjo vihet në organizma me ligj, me polici bashkiake të fundit dhe një diçka tjetër, bashki. Moj dakord jam, se ka bashkia, po ne t'ia kërkojmë edhe atij institucioni që e ka, se tashtitë pritet ujë, do të vijnë shtatëdhjetë, shtatëdhjetë çerek.Ne s'na lënë puna, na heqin vizën. Nuk lahemi dot, nuk ruhemi dotështë fakt ky. Dhe një diçka tjetër që të thoshja. Kam një ankesë nga qytetarët në unaza, që mos e ngre më.Ajo unaza shumë e mirë rruga, po vërej ndonjë pengesë, sepse kemi fëmijë, na dalin këtu, tha dhe ngriheni, tha. Të ketë ndonjë pengesë, siç i keni bërë këto, që të bjerë ajo e makinës, se kemi edhe fëmijë, që ngasin makina të papërgjegjshëm, pinë nga pinë dhe lëshohen e marrin edhe bëjnë një aksident.Dhe do të thosha prapë kryetar aty në lagjen time, po më tha dija juristi që e keni vënë atë kanalin të mbyllur dhe ashtu.E po e quaj të bërë, sepse thashë mos është harruar.Faleminderit.

Orinlidi Demollari: Kryetar, do ta dëgjosh se po, po.

Yllson Ibrahimllari: Atëherë, vitin e kaluar kemi marrë një nisëm dhe kemi miratuar rritjen e tarifës së ujit dhe kemi pasur dhe një debat me Idlirin aty ku është.Jo, jo, ç'rëndësi ka? Ne kemi tentuar.Nuk është në fuqi?

Petrit Kupe:Sështë tarifa e re.

Yllson Ibrahimllari: Nuk u miratua, nuk maten dot vlerat e kësaj pune që kemi bërë.Okej, atëherë s'paskemi lek. Po me ça ta paguajmë policin që thotë Fazlliu, se s'kemi lek. Faleminderit, atëherë.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Është e vërtetë ajo që tha dhe pak Petriti, që ka një rënie të burimeve gjithandej.Por kjo prapë nuk justifikohet që të kemi ujë me një orë e me dy orë në zona që kemi patur ujin se katër orë pa ndërprerje edhe që ka punonjës të papërgjegjshëm, që ka abuzim me ujin e pijshëm, gjithandej kjo është e vërtetë. Tashmë uji menaxhohet nga agjensia e ujësjellësit, nga drejtoria e ujësjellës kanalizimeve Korçë.Ne jemi aksionerë atje si bashki, po përqindja e aksioneve që kanë të gjitha bashkitë është 49% edhe qeveria është pesëdhjetë e një. Edhe nga ato çfarë po dëgjojmë ditët e fundit, ka mundësi që edhe ujësjellësi të kalojë në një si oshëja, që është sot një SH.A të përgjithshme, që të ketë një varësi vertikale e vërteta është që në territorin e Bashkisë Maliq gjatë kësaj periudhe po ka investime të rëndësishme në ujësjellëse , Podgëria tashmë merr njëzet e katër orë, që kishte një orë deri dy orë. Në zvezdë ka filluar të bëhet ujësjellës i ri. Në Pirg që kemi patur aty probleme, ka filluar ndërhyrja në stacionin e pompimit, po bëhet një ndërhyrje e re në burimet aty në kaptazhet. Themi, do ketë rregullimu bë një linjë e re, ajo që tha Petriti është e vërtetë, kanë bërë një linjë të re të ujësjellësit nga Kolaneci për t'i dhënë ujë Symizit direkt. Por kjo nuk do të thotë që ti të krijosh probleme për qesaratën, për aq familje. Që duhet të kontrolluar dhe uji i pijshëm mos shërbejë për vaditje, kjo është urgjent edhe ne nuk është se s'jemi të gatshëm, edhe ne si bashki me policinë bashkiake të dalim edhe e patjetër do ta çojmë këtë si shqetësim që ka dhe këshilli.Jo vetëm me Qesaratën nuk

kemi patur probleme, ajo çfarë tha Naqja për në Tërovë është e vërtetë. Po mos kishim shkuar ne të dy, ata do ishin pa ujë akoma. S'ka burimi atje, uji ikte lumë, po ku vete uji?Po jo, po aq, po nuk ngrihet. Po lidhën jo direkt, e lidhën direct.Ka ujë, sa nuk ka problem me, me sa di unë të paktën.Po ky, ky problem, ky problem mund të jetë kudo dhe ne kemi vajtur gjithmonë nga menaxhimi i punëve, jo vetëm ujësjellës kudo, ndoshta duhet filluar edhe këtë shqetësim tuaj, patjetër, unë do ta bëj me dije drejtorisë përkatëse të ujësjellës kanalizimeve në Korçë. Për qesaratën, po dhe për zonat tjera, ndoshta edhe për një reformë të thellë tek punonjësit e ujësjellësit, se njerëzit nuk dinë kush është punëtor. Po mirë mo le të marrin masa administrative, njerëzit duan të kenë ujë, nuk kanë problem. Është Gëzimi apo është Naqja punëtor. Kështu që në këtë, në këtë drejtim e kishin.

Prenvera Begolli: Aktualisht kemi lënë, për punën e pallateve andej lartë për të bërë çatitë, kur mendohet të bëhen nga lagjja ime dhe ajo rruga e asfaltimit të Bickës? Ju pyeta, prandaj një pyetje, në këtë moment që flasim me ty, isha nënën time.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Të gjitha pallatet që ka Maliqi, ka Liboniku, ka Drithasi, ka Vreshtasi, ka Vloçishti, kudo ka pallate, ne duam bërë një projekt të përgjithshëm.Po fillojmë nga ata që janë më të më të vështirët, nga ata që kanë më shumë risk, edhe vemi në ata të cilët.Jemi duke ndërmarrë një nisëm që do ta prezantojmë Këshillit të Bashkisë në fillim të vitit që vjen, që do t'i japim peshë edhe atyre që do të kenë një bashkëfinancim të komunitetit.Pasi ne investo, edhe banorët nuk bëhen merak apo i prishin, kjo nuk shkon më

Yllson Ibrahimllari: Si shkon problemi me emërimet e administratorëve? Se kanë dhënë dorëheqjen, më duket.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Me administratorët kemi bërë një shpallje për aplikime të reja dhe këta të opozitës, na kemi thënë që do bashkëqeverisim.

Yllson Ibrahimllari: Po s'e di me kë pjesë, do bashkëqeverisni.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Këto janë momente ose pozicione politike, që në një farë mënyre kryetari i bashkisë merr përsipër për të promovuar edhe punën, edhe për mirësinë të punës.

Yllson Ibrahimllari: Edhe këtu do dalë tymi i bardhë? Kur e kemi vendosur që t'i kthehemi?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Në mes të gushtit.

Floreta Zaçe: Problemin e kam në plehrat. Pavarësisht domethënë që ne nuk e ndërgjegjësojmë dot komunitetin, që zgjedh çdo lloj plehra në kazanet.Firma që është aktuale të mblidhet për arsyeja për të mbledhur dhe disinfektimi anë kaza kazaneve. Një e dyta. Duke pastruar fshat, domethënë duke u bërë këto kohë punë kaq të mëdha, ujësjellësa, rregullimet e rrugëve apo

ndriçimet apo dhe për një gjë kaq të vogël, që është mbartësi i gjithë mikrobeve me të këtë temperaturë kaq të lartë, dalin nga brenda fshatit del pastrami në sipërfaqe mbetet atje thahet dhe ky është barçi i fiksioneve. Duhet të kontrollojë punëtorët se sa orë punojnë, se si digjet puna dhe si duhet të mbarojë gjer në fund. Unë i shkoj punëtorët që punojnë dalin atje dy-tre minuta, ikin dhe e lënë në atë në sipërfaqe plehrat. Është shumë keq, ndërgjegjësimin mbajnë përgjegjësitë tona dhe komuniteti nuk është i ndërgjegjësuar, që të nxjerrë plehrat që janë, të nxjerr tashi tërë plehrat e baçës, i nxjerr atje, nuk është faji i firmës apo. Por megjithatë, atë që është, ne s'kemi të arrijmë aq sa kemi mundësi të hiqen këto plehra, të pastrohet vendi, të disinfektohet, se është shumë pra me tërë temperaturë të lartë që është.Në zonën tonë në Korçën apo në Maliq e bukur, muaji gusht dhe muaji shtator janë infeksione nga më të ndryshmet, sepse dalin zarzavatet dhe punimet që kanë fshatarët. Dhe kjo është akoma më.

Orinldi Demollari: Faleminderit, Lola.

Floreta Zaçe: Faleminderit juve.

Andonaq Risto: Atëherë doja të pyesja kryetarin, meqënëse jemi në një situatë shumë të vështirë edhe për vaditjen e ujit, për ujin e vaditjes të toka. Që a është marrë ndonjë masë, si mund të vazhdojë, sepse nga viti në vit gjendja po përkeqësohet dhe doja të dija të mbaroj. Doja të dija në qoftë se është mbledhur dikush për ta diskutuar që a ka ndonjë zgjidhje? Se njerëzit kanë, duan të dinë, të informohen, që të mbjellin me atë, t'i len tokat fara.Si mund të vazhdohet kjo pjesë? Domethënë sepse çdo vit po bëhet më keq, zgjidhje mund të ketë dhe ka se më përpara ka pasur rezervuar ose të bëhen diga ujëmbledhëse që gjatë dimrit të mblidhen dhe Të shfrytëzohet gjatë verës, mirëpo a është marrë njeri me këtë pjesë dhe a, se sot të themi që s'ka ujë, s'ka dhe s'ka, se zgjidh dot njeri, se ne e dimë dhe jemi të ndërgjegjshëm, por a do merren masa për më vonë? A merret njeri me këtë punë? A s'merret më? Sepse ne jemi domethënë po të vish në zonën ku ne jetojmë sot, që është Rrëmbeci, Rovi, trova, Pëndavinji. Nuk ka asnjë pikë ujë dhe njerëzit kanë hedhur lekë. Kanë punuar dhe sot shikojnë vetë sytë nga qielli. Prisni, ndjej sikur do binte flori. Mirëpo, nuk është ashtu dhe këtë duhet të dimë ndonjë përgjigje, domethënë që merret njeriu, a do më se di?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Është ndoshta, jo po, ndoshta po është problemi më i madh i fushës së Maliqit apo i komuniteteve tona. Situata është komplekse edhe ne po shikojmë disa zgjidhje, po propozojmë disa risi në lidhje me këtë punë. Por një gjë është e vërtetë, nuk mund të vaditet më me përmbytje fusha e Maliqit apo Baçat, duke i hapur krej lumin një bahçe në kohë, në gusht apo në shtator apo të tjera, nuk mund të vaditet në qoftë se kthejmë në vaditje me pika të paktën pjesën e perimores dhe ne po mendojmë për një projekt pilot në zonën e Pirgut, ku është edhe më e koncentruar mbjellja e perimeve të tjera dhe të njëjtën gjë duam ta zhvillojmë edhe në zonën e Pojanit për efekt të baçave të mollëve, të cilat janë të shumta dhe harxhojnë një sasi të madhe uji nga kaskada e Zëmblakut. Atë çfarë ne kemi propozuar Ministrisë së Bujqësisë dhe është ngritur një grup pune pas shqetësimeve që ne kemi ngritur, ka të bëjë me disa elementë.Duam të përmirësojmë disa ushqyes, siç është ushqyesi i Leminotit dhe

i Klocës. Duam të bëjmë një thellim dhe zgjerim të kaskadës së Zëmblakut, është bërë disa pak më parë, bile ka një propozim, ka një propozim nga bordi i kullimit Korçë, që aty të funksionojnë edhe dy pompa, siç paskam qënë më përpara, unë nuk e kam ditur që të shfrytëzohet i gjithë uji që mban kaskada.

Andonaq Risto: Në fakt, sepse atje ajo pjesa e kaskadës të zëmlakut është një ujë, domethënë është një kanal që vadit mbulon një zonë të madhe. Sistemi i përparëshëm aty ka qenë ka funksionuar nga liqeni i Prespës të Vogël dhe i Trenit, i cili nuk funksionon më se u bë park kombëtar dhe quhet krim mjedisor.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Nuk e marrin në konsideratë atë si moment. E kam diskutuar.

Andonaq Risto: Po është që atje i merrnim dhe atje vaditeshe pothuajse një e katërta mund të them e fushës së Korçës dhe është kanali vaditës më i madh që ka qarku Korçë, kanali i vendrokut, i cili mund të them që ka marrë miliona euro investime për të sjellë ujë dhe sepse është shqiptar i betonuar dhe që nga momenti kur u betonua, nuk ka sjellë më ujë. Dhe duke pyetur këta të kanalizimeve, po i shërbejmë si ujëmbledhës, që të mbledhësh ujë nga prenjtë në kanalin vaditës dhe të vaditësh.Si pa logjikë domethënë, megjithmonë se unë nuk jam specialist, por unë këmbëngul dhe them që duhet pastruar gryka e futjes të devollit në presë.Sepse ai është shpëtimi i gjithë zonës.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Nuk lejohet, e the pak më parë vetë, nuk lejojnë që ta dëmtojnë me liqenin e Prespës, sepse është në zonë të mbrojtur dhe nuk e lejojnë që uji. Të të them këto idetë time që kemi diskutuar me Ministrinë e Bujqësisë, se jemi duke kemi hartuar një projekt për një stacion të ri pompimi në Ura e Maliqi dhe një, por në qoftë se mbyllen portat shumë shpejt dhe ajo krijon një rezervë ujore për rreth pesëqind deri një mijë hektar sipas specialistëve në këtë zonë, që mbyll zonën nga Maliqi deri në Sovjane dhe deri në Novosel, lehtëson pjesën tjetër të Podgories, të Pirgut që marrin nga rezervuari i Pirgut, i Leminotit apo i ujëmblesave të tjerë. Mendojmë që duhet të fillojë edhe hapja e puseve në fushën e Maliqit.Kam filluar disi. Që ata të cilët kanë sasi toke të konsiderueshme në zonat e tyre të kenë puset e tyre, ne jemi duke hapur edhe një projekt pilot për elektrifikimin e fushës që të ketë një ulje të kostos që puset mos bëhen me naftë, po të jenë me korent sipas një sahati që të ketë në çdo në krye të çdo skoline. Janë ide.Ndonjëri njeri mund të thotë ore çfarë i kanë këto, por ne po gjykojmë dhe po propozojmë disa ide që mund ta lehtësojnë dhe mund ta përmirësojnë ujitjen në fushën e Maliqit. Edhe ajo çfarë thashë në fillim, ujitja me pika, do të jetë një zgjidhje dhe një kursim i ujit të pishë, i ujit të vaditës në të gjithë fushën e Maliqit, pasi me përmbytje nuk mund ta sigurojmë këtë gjë, probleme kanë nga më të ndryshmet komplekse për të themi. Kjo situatë e këtij viti ka qenë më e rënda.

Andonaq Risto: Me sa kam dëgjuar kryetar për pjesën e kanalit të Devollit flas, sepse andej është më problematika kryesore. Kam dëgjuar që në vitet më të para, në kohën e monizmit,

fliteshe që më përpara të diskutoheshe për një digë, mbase edhe më ndihmojnë dhe njerëzit që kanë qenë përpara në funksione të ndryshme. Në Koshnicë fliteshe për të ngritur një digë e madhe për të grumbulluar ujë dhe për ta shfrytëzuar në kohën e verës. Nuk e di me sa është e saktë, por e kam dëgjuar. Dhe a mund të bëhet dhe një?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Është e saktë dhe është diskutuar disa herë, por efektet e vlerës financiare janë shumë të mëdha dhe projektet që kanë të bëjnë me ujitjen po diskutohen nga Ministria e Bujqësisë për t'i futur me projekte të Bankës Botërore, që janë vende të mëdha, edhe pse afati i veprimit është më i ngadaltë se fondet e buxhetit të shtetit. Ndaj dhe ne mendojmë që disa që janë emergjente, këto i thashë më lartë, mund të financohen prej Ministrisë së Bujqësisë dhe ne kemi bërë propozimet konkrete, ndoshta një shqetësim i vetë edhe i Këshillit të Bashkisë në drejtim të Ministrisë së Bujqësisë për efekt të ujitjes do të ishte në linjën tonë dhe të themi se mund të na e lehtësonte punën.

Orinlidi Demollari: Patjetër, komisioni i bujqësisë.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Po, patjetër. Mund të çoni një shqetësim si këshillë bashkie tek ministri i bujqësisë për këtë qëllim.

Yllson Ibrahimllari:Meqë jemi tek kjo pikë, ne me sa shohim vit mbas viti shkojmë drejt një ngrohje globale. Thatësirat rriten, temperaturat ka studime të tilla, ndoshta në vjet këtu miratuam.një hedhje të dytë të Hidropaur Devollit, që do ngjitet në Bode, do ta çojë ujin.Ndoshta shikohet një hapësirë që duke lidhur këtë kanalin.Kjo që thotë zoti Andonaq, që unë kam qenë tek diku në fushë Krujë për të parë disa projekte, dhe kjo e kanalit të Vërtopit. Jo, jo, është projekti i ty ekzistues.Pra, kur kemi folur para nja dy vjetësh, këtu jemi rrëmbyer në sesin për të parë digat dhe dabat, ato dampat që keni.Ok!dakord, atëherë mund të mund të gjendet sistemi, mund të ketë alternativa që ky sistem i pompimit që do bëni aty të jetë me panele diellore, siç e ka bërë Tiranë Lanën që të jetë më pak e janë hapësirat për të diskutuar. Faleminderit.

Orinlidi Demollari: Atëherë, në qoftë se s'kemi gjë tjetër, kemi dy qytetarë aty që duhet t'i dëgjojmë.Hajde zotëri, e po, e po, jo.Ulu atje, atje, atje.

Qytetari: Unë jam Avni Fasho nga Kakaçi. Kam një problem me shpinë time. Të parën, shtëpia që bën pesë të nëntën, këta zotërinjtë inxhinierë që e kanë parë, e kanë bërë gjoja shtëpi pa leje, mbase edhe njëshit. Kam erdhur dje, kam bërë nja dy kërkesa, edhe nuk më është përgjigjur fare mirë Informatorja këtu. E është dera e parë, e dyta më vjen policia bashkiake, pavarësisht ngjyrave që i shllafosin këta Një Arefi bashkë me Gjonën kërcënoi familjen. E kini pE shpenesh, policia bashkiake po don me, është Arafiu i pari, edhe Ermal Gjona. E bëri në mars, e ka bërë tjetër. E di që tashi, atë do ta kishte qëruar që me kohë. Si kjo shtëpi e bërë në është bërë në pesëdhjetë e nëntën dhe ta shih më thonë është shtëpi pa lejë? Po ka numri dhe ka inxhinier, ekspert vij ta verifikoj.

Drejtori i Pronave Publike dhe Aseteve:z.Johand Sula:Për sqarimin e të gjithëve, fshati Kakaç është fshat i cili nuk ka dokumentacion zero njësh për trojet dhe ndërtesat përpara nëntëdhjetë e njëshit. Dhe për këtë arsye të gjithë qytetarët janë orientuar të aplikojnë për dokumentet 227. Rasti konkret i zotërisë është në proces përfundimi dhe në dijeninë time herën e parë u trajtua si dosje, sepse zotëria ka aplikuar për leje legalizimi dhe jo për objekt përpara nëntëdhjetë e njëshit dhe në këtë linjë, ashkaja ka punuar. Në dijeninë time i nxori dhe vendimin dhe kanë një konflikt për pjesën e rrugës të tokës.Kjo është nga herë që që hipoteka nuk e çoi deri në fund nismën e marrë. Aktualisht ka bërë një kërkesë pranë drejtorisë tone, për të marrë në dispozicion gjithë dokumentacionin dhe korrespondencën e kryer midis bashkisë dhe ashkës, jemi brenda afateve ligjore për t'ia përpunuar dhe për t'ia dhënë. Ndërsa dije, zotëria, nuk e di me kë ka kontaktuar, që ka shprehur pak kënaqësinë, sepse në momentin që jemi në zyrën tonë. Në momentin që e evidenton, ju sqarua, ju sqarua, sepse pretendon për dhënien nga ana jonë të një inxhinieri ndërtimi për t'i bërë ekspertizën përsa i përket kësaj pike, ne nuk mund t'ia plotësojmë, pasi nuk kemi tagrin ligjor. Aktualisht nga ne ka kërkuar dokumentacionin dhe korrespondencën.

Qytetari: Unë kam bërë shpia që bën pesëdhjetë e nëntën, kanë numrin. E kam futur këtë, jo unë mos m'ka pritur njeri fare.

Drejtori i Pronave Publike dhe Aseteve:z.Johand Sula: Po, po, po, po, po gjithë dokumentacionin e kam parë vetë.

Qytetari: Nuk kam bërë aplikim, kam kërkuar riparim shtëpie. E kam bërë riparimin e shtëpisë më dy mijë e shtatën. Se komshija që ishte, troqi çatë të tjerët ia ra, troqi çatë të tëmë. U detyrova e riparova me dy mijë e shtatën.Kam kërkuar leje, më tha mua tek riparimi i shtëpisë, nuk ke. Tashi na vijnë njëqind njerëz që nga zyra, mbas fotove që e kam bërë thonë në shtëpi, mbase edhe njerëzit pa titullar. E nuk është ajo që thotë zoti Andi, se atje s'ka shumë gazetë, se janë të tëra me harta me të tëra.

Drejtori i Pronave Publike dhe Aseteve:z.Johand Sula: Avni, të lutem, është një pjesë në të cilën e kemi sqaruar disa herë, që ta kuptojë edhe këshilli përse ke ardhur këtu.Nxirre pak dokumentacionin dhe të tregoj atë.

Qytetari: Vetëm për shpinë, pse nuk më del certfikata? Kam katër vjet poshtë e lartë.

Drejtori i Pronave Publike dhe Aseteve:z.Johand Sula: Po pra, dokumentacioni nëse objekti është i ndërtuar para të nëntëdhjetë e njëshit apo pas.

Qytetari: Po e ka tabelën atje, po lëvini që ke të mund ta ke tabelën. Unë dua drejtësinë. Po, po, ndero, po shikoj që nga policia bashkiake që vijnë pa një rekomandim pa një rekomandim me presion në shtëpi.Dua nga bashkia të vijë një ixhnier.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Do ta merrem menjëherë, patjetër. Por shpjegimi që të kanë dhënë tani, a ta plotëson ty atë që është e para në dhjetës, a është e pesëdhjetës?

Ornildi Demollari: Të lutem zotrri, po nuk e zgjidhim dot këtu në këshillat. Duhet ta shikosh me specialistët. Në si këshill dëgjuam vetëm shqetësimin tuaj dhe shpresoj që me specialistët të gjeni një zgjidhje. Faleminderit, zonja tjetër.

Qyetetarja: Bëra një kërkesë, se bëra një ndërhyrje në vesh këtë që vjet. Në ajo e këtyre asistencës e mirë më tha mua në dhjetor nuk ta japim dot, tha se kemi një problem më të vështirë se ty. Dakord, i thashë, nuk ma dha. Iku janari, shkurt i thanë, janë votimet, nuk ta japim se janë votimet, dakord. Tashi më ka më tha do të vëmë dyqind mijë leka, tashi më ka vënë njëqind mijë leka.Unë sa kam një muaj isha në spital, sa erdha në Tiranë edhe një ndihmë ekonomike që kisha kryetar maoqën, se isha vajta dhjetë në spi dhe një muaj, një muaj e siguruar maoqi. Po ju s'isha një muaj, unë s'e dinja. Po se ajo më tha do të vijë dyqind, pastaj më tha do të, pastaj më tha njëqind. Unë kam bërë dy ndërhyrje, ja sa kam që erdha nga spitali. Pa punë jam, çupën po ashtu pa punë, një punë desha për fëmijët, të paktën të më hyjë çupa në punë. Një nënë me dy fëmijë jetimër, një asnjë në punë nga fëmijët.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Ja një moment, atëherë faleminderit.

Ornildi Demollari: Duhet të na i propozojë kryetari një vlerën.Okej, atë bëjmë një votim, bëjmë një votim në parim.Bëjmë një votim në parim që të rishikojmë.Të shikohet mundësia për ndihmë financiare, kush është dakord. Mirë faleminderit, kjo ishte mbledhja për sot, ditë të mbarë.

Mbajtës Protokolli

SEKRETARI I KËSHILLIT

Gertjan GJIRITI

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - QARKU MALIQ - BASHKIA MALIQ